



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, propozuar nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.**
- 6. Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë deri në pikën 9).**
- 7. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data (prezent vetëm në një pjesë të pikës së parë).**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, propozuar nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku.

Ilir Rusi: Përshëndetje, anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak edhe të një situatë teknike, tashmë jemi në komunikim edhe me të tretët.

Ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor është në pamundësi objektive për të qenë prezent në këtë mbledhje.

Meqenëse është kuorumi i nevojshëm, po e deklaroj mbledhjen të hapur.

Ka diskutime për rendin e ditës?

Meqenëse nuk ka diskutime, do vazhdojmë sipas asaj çfarë është përcaktuar në rendin e ditës.

Pika e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”. Është një material i propozuar nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më tej fjalën relatores znj. Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë, po ju paraqes relacionin për projektvendimin “Për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky relacion në fakt vjen si pjesë e planit të strategjisë që është miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadër të uljes së backlog-ut, por nuk ka si qëllim, në kuptimin thelbësor uljen e numrit të backlog-ut, por përcaktimin e standardeve të njëjta për numrin e gjyqtarëve në raport me çështjet të cilat regjistrohen në secilën nga gjykatat.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1, 147/a, pika 1, shkronja ‘ë’, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 84, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 98/2016, është organi përgjegjës për propozimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë bashkë me propozimin për buxhetin e sistemit gjyqësor me qëllim sigurimin e ngarkesës së ekuilibruar të punës së të gjitha gjyqtarëve në Shqipëri. Këshilli i Lartë Gjyqësor mbikëqyr ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe punës së gjykatave dhe nëse është e nevojshme rishikon numrin e gjyqtarëve.

Bazuar në dispozitat e mësipërme, pas miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, Këshilli ka miratuar vendimin nr. 553, datë 29.12.2022, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm”, duke qenë se pjesë e riorganizimit nuk ka qenë Gjykata e Apelit të Juridiksionit Administrativ; vendimin nr. 146, datë 29.03.2023, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm” dhe vendimin nr. 286, datë 29.05.2023, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat administrative

të shkallës së parë”. Në këto vendime Këshilli ka parashikuar se, numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm është 78 gjyqtarë, numri i gjyqtarëve në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm është 235 gjyqtarë dhe numri i gjyqtarëve të gjykatave administrative të shkallës së parë është 36 gjyqtarë. (d.m.th. i të dyja gjykatave si administrative e Lushnjës dhe e gjykatës së shkallës së parë të Tiranës, administrative). Numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar është 16 dhe numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit është 11 gjyqtarë, sipas numrit minimal të përcaktuar nga ligji dhe vendimeve përkatëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 7818, datë 16.11.2012, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”, i ndryshuar, numri i gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit është 13 (trembëdhjetë) gjyqtarë.

Totali i numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë është aktualisht 408 gjyqtarësh.

Gjykata e Lartë ka 19 gjyqtarë.

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka 78 gjyqtarë.

Gjykata e Apelit Administrativ ka 13.

Siç e relatuar edhe më sipër. Janë të njëjtat numra. Ku numri i përgjithshëm është 408.

Detyrimi i Këshillit për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë buron nga neni 22 i Ligjit 98/2016, ku parashikohet se:

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor mbikëqyr vazhdimisht ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave, duke u bazuar në të dhënat e mbledhura, me qëllim përmirësimin e efijencës së gjykatave ose zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përgatit dhe publikon brenda muajit qershor të çdo viti raportin vjetor për ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave për vitin kalendarik të mëparshëm, duke përfshirë rekomandime për përmirësimin e efijencës

së gjykatave ose për zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës.

3. Të paktën çdo pesë vjet Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë dhe nëse është e nevojshme rishikon numrin e gjyqtarëve pas marrjes së mendimit nga Këshilli i Gjykatës.

4. Procesi i përcaktimit të numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë mbështetet në objektivat e parashikuar në nenin 14, të këtij ligji, me qëllim sigurimin e ngarkesës së ekuilibruar të punës së gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë. Procesi kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në analizën e raporteve vjetore dhe efikasitetit të masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në raportet vjetore, sipas pikës 2 të këtij neni.

I qartë për detyrimin ligjor si më sipër, Këshilli vlerësoi rishikimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë, ishte proces që lidhej pazgjidhshmërisht me procesin e riorganizimit e rishikimit të madhësisë së gjykatave (Harta Gjyqësore), sepse të dy proceset kërkonin analizë disavjeçare të ngarkesës së gjykatave ndaj edhe miratoi ndryshimet përkatëse të numrit të gjykatave. Domethënë propozimi për numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve, ky ndryshim është bërë pas një analize dhe në kuadër të hartës së re gjyqësore e cila është miratuar dhe po funksionon.

Pjesë e analizës që çoi në propozimin e hartës së re gjyqësore ishte edhe një vlerësim për shpërndarjen optimale të gjyqtarëve. Vlerësimi u bazua në një kategorizim të thjeshtë të çështjeve, duke i ndarë ato në çështje me një shkallë mesatare kompleksiteti, që kërkon më shumë kohë gjyqësore dhe burime nga gjykatat, si dhe çështje të thjeshta, të cilat kërkojnë më pak kohë e burime.

Pra analiza e të dhënave është bërë duke i marrë të dhënat statistikore edhe për llojin e çështjeve, jo vetëm për numrin e çështjeve. Kush janë çështjet më të vështira, kush janë çështjet mesatare dhe çështjet e thjeshta të cilat nuk kërkojnë kohë dhe angazhim të lartë të gjyqtarëve.

Vlerësimi u bë veçmas për çdo lloj çështjeje. Ndërsa kjo analizë do të na tregonte shpërndarjen optimale të gjyqtarëve mes rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykata administrative të shkallës së parë dhe riorganizimit të kompetencave të tyre tokësore, në të nuk u përfshi vlerësimi sa i takon

shpërndarjes optimale të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit, për shkak se kjo gjykatë nuk prekej nga riorganizimi i kompetencave tokësore.

Kompetenca tokësore e Gjykatës Administrative të Apelit përcaktohet shprehimisht në nenin 12 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Detyrimi i Këshillit për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve buron edhe nga neni 21 i Ligjit 98/2016.

Statusi aktual i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Administrativ, duke qenë se këtu është propozuar rritja e numrit, konkretisht është: 6 gjyqtarë në detyrë; 5 gjyqtarë në skemën e delegimi (11 gjyqtarë).

Aktualisht kemi edhe në rend dite një propozim tjetër për rritjen e numrit të gjyqtarëve në skemë delegimi, duke e çuar në numrin e plotë, në 13 (kjo është jashtë relacionit).

Numri i çështjeve të regjistruara në pritje për gjykim në Gjykatën Administrative është si më poshtë.

Sipas informacionit të administruar nga Gjykata Administrative e Apelit, deri në datë 15 shtator 2024, pranë kësaj gjykate rezultojnë 23.550 çështje në pritje për gjykim, me një mesatare prej 2,140.9 çështje për gjyqtar.

Në vijim, të dhënat janë parashikuar në tabelë për llojin dhe kategorizimet e ndryshme të çështjeve, ku janë edhe përqindjet për secilën lloj çështje, ku kuptohet edhe natyra e tyre apo vështirësitë që mund të ketë në gjykimin e tyre.

Në tabelën e mësipërme nuk janë përfshirë 4653 çështje, të regjistruara në Gjykatën Administrative të Apelit si kërkesa (sigurim padie, lëshim urdhër ekzekutimi, sqarim/interpretim vendimi, rishikim vendimi, shkelje afati gjykimi, etj).

Për të pasur një vlerësim të nevojës së përgjithshme për gjyqtarë të Gjykatës Administrative (*apelit*) është vijuar me prezumimin e shtesës së kompleksitetit të çështjes administrative, është i krahasueshëm me një miks çështjesh civile themeli me palë kundërshtare dhe çështjesh penale themeli. Në mënyrë të ngjashme, është prezumuar se kërkesat e tjera administrative kanë të njëjtën shkallë kompleksiteti si çështjet civile pa palë kundërshtare. Është e qartë se një ushtrim më i thelluar për peshimin e çështjeve do

të përmirësonte cilësinë dhe saktësinë e parashikimeve, por ky është një ushtrim që kërkon kohë dhe një studim të detajuar të kohës gjyqësore.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i detyruar të shpërndajë gjyqtarët në një mënyrë të tillë që ngarkesa mes gjyqtarëve të jetë e barabartë, për aq sa është e mundur. Kjo është një detyrë e vështirë për sa kohë nuk ka një analizë të thelluar me studime të peshës së çështjeve dhe ngarkesës të të gjitha llojeve të çështjeve të gjykuara. Pas një analize të kombinuar të të gjithë indikatorëve, faktorëve dhe objektivave të parashikuar nga neni 14 i Ligjit nr. 98/2016, Gjykata Administrative e Apelit do të ketë nevojë për të paktën 19 pozicione gjyqtarësh (krahasuar me 13 pozicione që ka aktualisht), si mekanizmi kryesor i ekuilibrit të ngarkesës së gjykatës dhe vetë gjyqtarëve, duke siguruar një rishpërndarje të drejtë të ngarkesës së gjyqtarëve me gjyqtarët e juridiksionit të apelit të përgjithshëm.

Për të përcaktuar ngarkesën e punës treguesit janë vlerësuar duke kërkuar vendosjen e një ekuilibri midis shpërndarjes së ngarkesës në punë, shpërndarjes së gjyqtarëve, si dhe numrit minimal të gjyqtarëve në çdo gjykatë. Ngarkesa e gjykatës është përcaktuar jo vetëm nga numri total i çështjeve të reja, por edhe nga lloji i këtyre çështjeve, pra nëse çështjet e ndërlikuara dhe ato që marrin kohë përbëjnë përqindjen më të vogël apo atë më të madhe të çështjeve të një gjykate.

Raporti Vlerësues i grupit të punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor (këtu po citoj raportin vlerësues) me vendimin nr. 252, datë 09.05.2024 ka miratuar “Raportin vlerësues të grupit të punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë” me anë të cilit është propozuar që numri i gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit të rritet nga 13 në 19 gjyqtarë. Për shkak të rritjes së numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit me 6 gjyqtarë, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve do të duhej të rritej nga 408 në 414 pozicione.

Me shkresën nr. 2538/2 prot., datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave me shkresat përcjellëse duke dhënë për mendim për Raportin Vlerësues.

Gjithashtu, në zbatim të pikës nr. 3 të vendimit 252 (*citohet gabimisht 258*) është kryer publikimi në faqen uebit. Nga verifikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, rezulton se nuk ka pasur komente apo sugjerime brenda afatit të përcaktuar nga ligji.

Në vijim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë administruar shkresat e Gjykatës Administrative të Apelit me lëndën që “Dërgohet mendim për Raportin vlerësues”. Me anë të kësaj shkrese Gjykata Administrative e Apelit informon se gjyqtarët të cilët ushtrojnë funksionin pranë kësaj gjykate, pasi janë njohur me këtë vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, njëzëri shprehin vlerësimin dhe mbështetjen për rritjen numrit të gjyqtarëve në këtë gjykatë.

Gjithashtu është kërkuar mendim dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër e cila në kthim të përgjigjes është vendosur shprehja pozitive e mendimit dhe dakordësisë nga ana e Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Gjithashtu është administruar dhe shkresa e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Me anë të kësaj shkrese është përcjellë edhe mendimi i këshillit të gjykatës së posaçme i cili shpreh mendimin në lidhje me numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve, dhe me specifikat e Gjykatës Administrative, nevojën e një studimi më të thelluar.

Gjithashtu në vijim, në Këshill janë administruar përgjigjet e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Berat, Fier dhe Dibër, të cilat ju i keni në relacion.

Në mbledhjen plenare të datës 09.05.2024, pati diskutime mbi projekt-aktin “Për miratimin e raportit vlerësues të Grupit të Punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura”. Duke parë në projeksion situatën kur janë krijuar dhe si ka evoluar juridiksioni i gjykatave administrative, faktit që Gjykata Administrative e Apelit është një gjykatë e vetme, me qëllim rritjen e performancës, dhe uljen e efekteve negative të backlog-ut në këtë gjykatë, nga ana e anëtarëve të Këshillit (në fakt nga njëri anëtar) është propozuar alternativa për rritjen e numrit të Gjykatës Administrative të Apelit me 9 gjyqtarë.

Sipas këtij propozimi, numri shkon në 22 nga 13 që ka aktualisht. Domethënë në

këtë relacion është bërë e ditur edhe propozimi që ka ardhur në mbledhjen e datës 09.04.2024 (*mbledhja ka qenë 09.05.2024*).

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë opinionet e shprehura lidhur me Raportin Vlerësues për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, dhe propozimit alternativ propozohet kalimi për shqyrtim në mbledhjen plenare, duke propozuar rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative.

Duke qenë se, kam qenë pjesë e grupit të punës, megjithëse relacioni është bërë duke e lënë në dorë të Këshillit, duke qenë se kam qenë pjesë e grupit të punës, unë i qëndroj propozimit i cili ka ardhur pranë Këshillit, me rritjen e numrit të gjyqtarëve nga 13 në 19, duke e rritur me 3 trupa gjykues, kjo referuar të dhënave statistikore të cilat janë administruar në kuadër të grupit të punës dhe është hartuar edhe një raport vlerësues edhe nga ekspertët ndërkombëtarë të cilët kanë mbledhur të dhëna statistikore dhe kanë bërë ndarjen, domethënë kanë propozuar rritjen e numrit të gjyqtarëve. Në fakt propozimi nga ndërkombëtarët, referuar analizave statistikore, ka qenë 18, kjo nisur nga numri i çështjeve të regjistruara. Pasi, numri i gjyqtarëve nuk përcaktohet nga çështjet e prapambetura por nga numri i çështjeve të regjistruara dhe detyrimi i Këshillit është që të garantojë një barazi të ngarkesës ndërmjet të gjithë gjykatave të Republikës së Shqipërisë dhe gjykatave në të njëjtin nivel. Referuar kësaj ngarkese e cila ka rezultuar nga numri i çështjeve të regjistruara, aktualisht është propozuar numri 18 që të kemi një barazi me juridiksionin e përgjithshëm, me juridiksionin e posaçëm, sepse aq shkon numri i çështjeve të regjistruara. Numri i çështjeve të regjistruara për secilin gjyqtar çdo vit, aktualisht në Gjykatën Administrative ka ardhur në ulje (këtë po e them unë në fakt), përveçse ka pasur... domethënë nga të dhënat statistikore numri i çështjeve ka ardhur gjithmonë duke u ulur, ka qenë viti 2013, 2014 ku ka pasur një rritje për shkak edhe të vendimeve unifikuese, dhe atëherë ka arritur kulmin, por duhet të kujtojmë se numri i gjyqtarëve në atë kohë ka qenë 7 dhe pasur parasysh dy vendimet unifikuese (dhe mbase në atë moment është krijuar edhe backlog-u) është propozuar më pas rritja e numrit nga 7 në 13. Është rritur një trup gjykues.

Mund të themi që normalisht tek backlog-u ka ndikuar edhe vetting-u, absolutisht, ku ka ndikuar në të gjithë gjykatat e Republikës së Shqipërisë. Por numri i çështjeve ka ardhur gjithmonë duke u zbritur dhe aktualisht numri i çështjeve të regjistruara pranë

Gjykatës Administrative e Apelit është 3.500. Po marrim aktualisht, ka ardhur gjithmonë duke u ulur, por nuk ka kaluar asnjëherë, megjithëse mund të ketë pasur luhate, nuk ka kaluar asnjëherë 4.000. Se u ngrit propozimi për sa i përket Gjykatës së Apelit të Përgjithshëm. Apeli i përgjithshëm ka pasur një ulje të numrit të çështjeve të regjistruara vetëm për periudhën që ka qenë koha e vetting-ut dhe kjo dihet për shkak se gjykatat e shkallës së parë kanë qenë thajse pa gjyqtarë, por aktualisht ka shkuar deri në 15.000 numri i çështjeve të regjistruara. Pra është krahasimisht shumë e madhe numri i çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe po të pjesëtojmë numrin e çështjeve të regjistruara me numrin e çështjeve për gjyqtar jo efektiv për numrin e organikës, rezulton pak a shumë të jemi tek i njëjti nivel.. numri çështjesh. Pse? Sepse Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm shkon gati 200 çështje referuar numrit të çështjeve të regjistruara me numrin e gjyqtarëve 78 (jo aktualisht, sepse nuk merret gjendja në të cilën ndodhet, por atë që ne kemi në organikë), 78, shkon rreth 200 çështje. Po ta pjesëtojmë numrin 3.500 me numrin 18, nuk shkon 200. Po ta pjesëtojmë me 19, shkon 180 çështje.

Ne kemi detyrimin që të ruajmë, kur bëjmë një propozim të tillë, që të ruajmë edhe ngarkesën e njëjtë. Aq më tepër që po t'i referohemi standardeve të miratuara më parë nga Këshilli, ne kemi detyrimin, Këshilli ka detyrimin që edhe të garantojë një ngarkesë dhe secili gjyqtar të plotësojë ato standarde të cilat do vendosen.

Kemi një projekt të cilin e kemi propozuar për rritjen e standardeve, por po t'i referohemi standardeve të miratuara në 2010, që absolutisht nuk kishte këtë ngarkesë, gjyqtarët duhet të gjykojnë minimumi 200 çështje në vit.

Po të çojmë numrin 19, asnjëri nuk e plotëson këtë standard. Kështu që, prandaj i qëndroj këtij propozimi, të cilin e kam propozuar edhe këtë, sepse është bërë mbi bazën e të dhënave statistikore. Gjithashtu do të shtoja edhe, aktualisht ne nuk kemi as burime njerëzore, për të çuar numrin 22 të Gjykatës Administrative të Apelit sepse ne kur parashikojmë që të çojmë numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve në një numër të caktuar, duhet të shikojmë edhe si i kemi burimet njerëzore. Nuk është çështje vetëm të hapim vende. Po duket sikur po rrisim numrin. Por duhet të dimë edhe sa gjyqtarë do çojmë atje. Aktualisht ne nuk i kemi këto mundësi për të çuar gjyqtarët, pasur parasysh procesin e vetting-ut, pasur parasysh aktualisht sa kemi gjyqtarë të cilët plotësojnë kushtet për të

qenë gjyqtarë të Gjykatës Administrative me eksperiencën e tyre të apelit, gjithmonë duke mbajtur parasysh që duhet të ruajmë edhe cilësinë, nuk është çështje vetëm e numrit. Kështu që unë i qëndroj propozimit 19 edhe për faktin se ne kemi në çdo moment detyrimin që të rishikojmë numrin referuar të dhënave statistikore. Ne nuk mund të bëjmë propozime tej të dhënave statistikore sepse nuk do jemi të besueshëm atyre që do t'i çojmë propozimin. Fakti që ne duhet t'i çojmë numrin 25, 22, 30 (po marr shembuj), numri i gjyqtarëve nuk përcaktohet nga backlog-u, absolutisht nuk përcaktohet nga backlog-u, përcaktohet nga numri i çështjeve që regjistrohen. E njëjta praktikë, e njëjta taktikë është votuar edhe nga Këshilli kur është miratuar harta gjyqësore, në të cilën është propozuar edhe numri në secilën gjykatë që ne vendosëm që të miratojmë, përveç apelit administrativ, të cilin nuk e kishim pjesë të riorganizimit. Ndërsa të gjithë gjykatat e tjera, ne pamë, jo vetëm kaq, por pamë edhe ngarkesën e secilës gjykatë dhe vendosëm që në Gjykatën e Apelit të Përgjithshëm do kishte 78; në Gjykatën e Tiranës do kishte 80. Më kupton? Apo në Gjykatën e Beratit ndryshuam 7 me 8 numrin e përgjithshëm. Pse? Duke iu referuar numrit të çështjeve që regjistrohen, por kemi mbajtur parasysh edhe krijimin e trupave gjyqësore.

(I përgjigjet një anëtar) Po, sepse kishim Tiranën... për shkak të ngarkesës së Tiranës, numrit të çështjeve të regjistruara. Unë nuk po them që nuk ndryshohet. Unë po them që ne, kur i referohemi të dhënave, ne kur do bëjmë propozimin, nuk mund t'i referohemi çështjeve të prapambetura, dhe nuk është argument asnjëherë, nuk mund të përdoret si argument “çështjeve të prapambetura”, sepse ne nuk caktojmë gjyqtarë dhe më pas t'i heqim. Caktojmë gjyqtarë në bazë të çështjeve që regjistrohen. Kjo është një analizë statistikore që e ndjekin të gjithë dhe jo vetëm Shqipëria, kështu që.

Unë i qëndroj propozimit.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime?

Po, zoti Kurushi!

(Pas disa minutash rimerr edhe një herë fjalën z. Rusi.)

Ilir Rusi: Atëherë në vijim, për shkak se edhe jemi bërë me dije se nga Drejtoria e

Teknologjisë që mund të ketë situata që mund të shkëputet komunikimi me të tretët, fjala është për z. Kurushi, sikundër e kemi dhënë kohë më parë.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar kolegë!

Sot jemi përpara mbledhjes për të marrë një vendim të rëndësishëm që lidhet me rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë.

Unë e dëgjova edhe parashtrimin e relacionit që është bërë nga grupi i punës. Shpreh falënderimet e mia për kontributin që kanë dhënë dhe për propozimet e tyre që kanë dhënë në lidhje me rritjen e numrit të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Administrativ si dhe në rritjen e numrit të përgjithshëm, pra që kjo do reflektojë më pas në rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Shqipëri.

Gjithsesi, më duhet të evidentoj disa situata të cilat unë mendoj se duhet t'ia bëjmë prezent Këshillit dhe bashkë me këto situata paraqes edhe një herë, riparaqes propozimin tim për një rritje alternative të numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit.

Referuar analizës së bërë, mua më rezulton që për të vlerësuar nevojën e përgjithshme për gjyqtarët në Gjykatën Administrative të Apelit, janë marrë, në metodologjinë e punës, nga grupi i punës është vijuar me analizën e bërë për kompleksitetin e çështjeve që gjykohen në Gjykatën Administrative të Apelit dhe si metodë krahasuese për të evidentuar kompleksitetin e çështjeve janë marrë si kampione krahasuese një miks çështjesh civile themeli me palë kundërshtare, çështje penale, si dhe vetë çështjet e Gjykatës Administrative të Apelit.

Tani mendoj që në këtë rast nuk ka gjetur pasqyrim një realitet i cili shoqërohet edhe me një qasje të re të Gjykatës së Apelit Administrativ për shqyrtimin e çështjeve qa asaj i vijnë në gjykim, si juridiksion rishikues por ashtu edhe si juridiksion fillestar.

Pse e them këtë?

Them që në këtë rast gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, kur është marrë kampioni krahasues, të cilët gjykojnë si çështje civile ashtu edhe çështje penale, në natyrën e kompleksitetit të çështjes dhe procedurën që ndjekin për gjykimin e këtyre

12

çështjeve nuk është realisht e njëjtë me gjykimin e çështjeve që gjykohen në Gjykatën Administrative të Apelit. Pse?

Mund t'ju përmend disa herë, legjislatori ka ndryshuar legjislacionin që ka afektuar edhe qasjen dhe ndryshimin e gjykimit të çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit si gjykatë që gjykon edhe si juridiksion fillestar. Në këtë pikë gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, seksioni civile dhe penale, nuk gjykojnë si gjykata në juridiksion fillestar. Mund t'ju përmend disa ligje, që kanë detyruar, po themi, gjykatën administrative të apelit të gjykojë si gjykatë e juridiksionit fillestar. Cilat janë, disa, jo të gjitha. Mund të përmend ligjin nr. 133/2015 “për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Këtu janë 661 çështje, që gjykohet si gjykatë e shkallës së parë (në bazë të statistikave që unë kam marrë ndër vite në Gjykatën e Apelit Administrativ).

Më tej, kemi ligjin 162/2020 “për prokurimin publik”. Janë 129 çështje (sipas statistikave që unë kam marrë). Gjykohet nga Gjykata Administrative e Apelit si gjykatë e shkallës së parë, pra në juridiksion fillestar).

Mund të përmend ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pra ligji 115/2016, e cila gjykon aktet e nxjerra nga organet e sistemit të drejtësisë (ILD, KLP, KLGJ), në disa raste gjykohen drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative të Apelit, si gjykatë e shkallës së parë.

Përmendim ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që vendimet të cilat lidhen me karrierën e gjyqtarëve, vendime të cilat merren nga KLP dhe KLGJ, gjykohen si gjykatë e shkallës së parë, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Kemi raste të tjera?

Gjykimin e akteve normative, është gjykim i posaçëm i cili kërkon jo më tre gjyqtarë, por kërkon pesë gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Apelit. E shikoj që këto raste dhe po themi, ky profilizim i ri, i sjellë nga ligji për gjykatën administrative të apelit, duhet (mendoj unë), të gjente pasqyrim ndoshta më specifik në analizën që është paraqitur sot për diskutim. Kjo është një arsye. Dhe në këtë pikë unë mendoj që referuar natyrës së çështjeve për shkak të ligjeve që e kanë autorizuar gjykimin e tyre në Gjykatën e Apelit Administrativ, si gjykatë e shkallës së parë, pra si një proces hiring, jo gjykim

rishikues, atëherë kjo mendoj unë duhet të reflektojë edhe në paraqitjen, përzgjedhjen e një numri real gjyqtarësh si burime njerëzore, që të përballojnë ngarkesën për ta zgjidhur çështjen brenda një afati të arsyeshëm kohor.

E dyta, çfarë unë duhet të them. Gjatë kësaj analize mbaj në konsideratë ligjin ekzistues, nenin 49 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”. Specifikisht, kjo dispozitë ligjore përcakton afatin e fillimit dhe të përfundimit të çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit, sigurisht si gjykime në një juridiksion rishikues, brenda 30 ditësh.

Tani, unë kam marrë statistikën e mia ndër vite, nga viti 2013 deri në vitin 2023. Kjo lloj statistike në këtë rast nuk ka lidhje me numrin e çështjeve, ka lidhje vetëm me respektimin e afatit të gjykimit që parashikon neni 48, paragrafi 2, i ligjit 49/2012, pra vetëm me respektimin e këtij afati kohor. Është bërë në vitin 2012 dhe i është shtuar më pas edhe numri i gjyqtarëve, pas vendimeve unifikuese që kanë dalë, pra nga 7, shkoi në 13. Dhe nuk po marr vitet e mëparshme, por po marr vitet e fundit, pra nga 2013 deri në 2016 me një mesatare në statistikën e mia, mua më rezulton se ky afat është respektuar edhe kundrejt kontributit të sakrificës së gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit, në masën 10% maksimum në vit, pra 10% e vendimeve të dhëna, mund të jetë respektuar afati 30-ditor. 90% jashtë këtij afati. Arsyeja? Nuk flasim për numër çështjesh. Ma kuptoni këtë pjesën. Është tjetër gjë numri i çështjeve. S’po e diskutoj numrin. Diskutoj afatin ligjor, kompleksitetin e çështjeve që ka gjykata si dhe në ndonjë rast të veçantë gjykimin me një trup gjykues të ndryshëm nga ai që gjykon zakonisht prej 3 gjyqtarësh. Pra bëhen 5.

Tani, duke marrë në konsideratë këto situata të reja, unë vazhdoj t’i qëndroj propozimit tim. Pra dakordësohem pjesërisht me propozimin që numri i gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit duhet të shtohet. Për këtë unë dakordësohem. Por nuk jam dakord me numrin... pra pjesërisht jam dakord me shtimin e numrit, por me numrin e propozuar nga grupi i punës unë nuk jam dakord, duke iu referuar këtyre argumenteve që unë sapo i dhashë. Në këtë pikë, unë propozoj që së paku, sipas propozimit tim, duhet të shkojë edhe një trup tjetër gjykues, domethënë edhe një treshe tjetër. Nga 6 sa është propozuar nga grupi i punës, të shkojë në 9. Dhe në total të shkojë nga 19, që është propozuar nga grupi i punës, gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Apelit, në 22

gjqtarë në Gjykatën Administrative të Apelit. Dhe prapë mendoj dhe jam në rezervë që ky numër nuk është se me këtë numër do përmbushen të gjitha standardet e kërkuara nga ligji për gjykimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, si dhe nuk do përmbushen ndoshta standardet e cilësisë, e afateve për gjykimin e çështjeve si juridiksione fillestarësh, por jam i bindur që do ketë një përmirësim të ndjeshëm të punës në Gjykatën Administrative të Apelit dhe pse jo, këtë e ngre unë si një argument shtesë, mos t'i ofrojë mundësi Gjykatës Administrative të Apelit të ndajë edhe ajo seksionet e veta, në bazë të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor". Po pse mos të ketë një seksion për gjykimin e çështjeve si një gjykatë e juridiksionit fillestar. Një treshe. Për sa kohë ligji e lejon.

(Dikush nga anëtarët ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)

Më fal, unë dhashë disa shembuj. Janë në statistika se si Gjykata Administrative e Apelit gjykon si gjykatë e juridiksionit fillestar për shkak të disa inkorporimi ligjesh. Tani, nëse ne duam dhe shkojmë drejt profilizimit ashtu sikundër kemi bërë me hartën që të shkojmë drejt profilizimit, drejt ndarjes së seksioneve, edhe seksionet i ndajmë në nënseksione. Pse mos të japim mundësi ta zhvillojë vetë, ta diskutojë vetë Gjykata e Apelit? Pse mos t'i japim mundësi për shkak të numrit, që Gjykata Administrative e Apelit të krijojë një seksion hipotetikusht (është hipotezë, është çështje e ngritur) për gjykimin e çështjeve si gjykatë e juridiksionit fillestar (një treshe).

Kështu që në këtë pikë, unë vazhdoj t'i qëndroj propozimit tim që numri i përgjithshëm i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Administrativ të jetë nga 19 i propozuar nga grupi i punës, në 22, me këto argumente që unë i përmenda më lart.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime të tjera në vijim nga anëtarët?

Po, zonja Muçi!

Emona Muçi: Edhe unë kam të njëjtin mendim si parafolësi. Jam pjesërisht dakord me relatoren për rritjen e numrit të gjyqtarëve pranë gjykatës së apelit. Mbjaj në vëmendje të gjithë argumentet që dha parafolësi. Jam shumë dakord. Mbjaj në

15

vëmendje faktin që Gjykata Administrative e Apelit është një gjykatë e cila në numrin më të madh, jo më të madh, por thelbësor të çështjeve, ato janë të natyrës administrative, shto këtu vështirësinë në lidhje me përgatitjen e çështjeve të cilat kanë të bëjnë me... të cilat në themel të tyre legjislacioni është legjislacioni që vjen të themi me ndryshime dinamike, të cilat paraqesin edhe një përgatitje, një kohë, duan një kohë më të madhe përgatitjeje në krahasim me çështje të cilat mund të gjykohen nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, sikurse mund të jenë ato të karakterit, çështje civile apo çështje penale. Duke mbajtur në vëmendje të gjitha këto, duke mbajtur në vëmendje qoftë duke u nisur, të themi, pikënisja mund të jetë statistikave dhe numri i çështjeve për gjyqtar sikurse është analizuar gjerë e gjatë në raport dhe që të kemi një barazi ndërmjet gjykatave të të njëjtit nivel, të themi Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm apo gjykatat e apelit të juridiksionit, më falni, administrativ; por duke futur edhe këto komponentë të cilët janë shumë të rëndësishëm, natyra e çështjeve, afatet strikte që ligji parashikon, pikërisht për të mos i dhënë... jo vetëm për të mos i dhënë qytetarit, por qytetari i cili, të themi, ankimon ose bën konflikte gjyqësore, veprimtaritë e përditshme administrative, të marri përgjigje brenda atyre afateve ligjore, me qëllim që të ketë kuptim edhe ligji; por gjithashtu duke mbajtur në vëmendje dhe karakteristikat e disa lloj gjykimeve të cilat sikurse tha parafolësi, gjykimet në lidhje me aktet normative, gjyqtarët të cilët duhet të formojnë trupën gjyqësore janë 5 dhe neve nuk mund të parashikojmë... ne do të krijojmë mundësinë dhe komoditetin gjyqtarëve për të gjykuar, por ne nuk mund të parashikojmë numra. Unë mendoj që mund të kemi, mund të jetë e arsyeshme që të rritet edhe me një trupë tjetër. Nuk është asnjë gjë e keqe nëse qytetari në fund të fundit merr drejtësinë në kohën e parashikuar në ligj sipas pritshmërive ligjore. Ndërkohë ne kemi përpara strategjinë e cila është, të themi, gur themeli për ne që mund të jemi këtë 5-vjeçar, për të tjerët, me stokun e krijuar, mund të përshpejtohen të gjitha këto objektiva të arritura. Ky është mendimi im. Jam për rritje të numrit të gjyqtarëve. Gjithsesi e lë në çmimin tuaj në lidhje me numrin: në qoftë se ky duhet të jetë 6 + 3 apo 6 + 6 të tjera.

Sot kemi nevojë për gjyqtarë të cilët të ndihen komod në punën e tyre. Kemi nevojë pas gjithë këtyre viteve, pas gjithë këtyre streseve. Gjyqtarët nuk janë më të freskët për të gjykuar. Kanë punuar për vite të gjithë në urgjencë. Kanë punuar në mbingarkesë. Nuk mund t'i kërkojmë akoma të gjykojnë në mbingarkesë. Por edhe

qytetarëve nuk mund t'u themi që prisni edhe 5-6 vjet të tjera. Ky është mendimi im personal.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçi!

Po, zoti Tabaku kërkon fjalën.

Albens Tabaku: Faleminderit zoti Rusi!

Desha të shtoj edhe unë disa fjalë pa përsëritur ato që thanë parafolësit, duke i ezauruar çështjet e juridiksionit fillestar që gjykon Gjykata e Apelit Administrativ, kompleksitetin e çështjeve administrative, shtimin e gamës për shkak të vendimeve unifikuese. Në faqen 4 të relacionit janë shprehur llojet e çështjeve. Por në nenin 17 të ligjit 49/2012 janë akoma edhe më të gjera gama e çështjeve. Mjafton të përmend nenin 17, pika “g” për zgjidhjen e mosmarëveshjeve të punës kur punëdhënësi është një organ i administratës publike. Sa i kushton shtetit çështjet e marrëdhënieve të punësimit të cilat janë në pritje dhe që mund të dublohen, kur afati mund të ishte shumë herë më i shkurtër, 30-ditor.

Duhet të kemi kujdes me statistikën, se statistikën, imputet, pra ato që futen, janë shumë herë dinamike dhe outputet që dalin mund të jenë outpute të cilat mund të jenë joinformuese, por dezinformuese. Atëherë unë po i referohem raportit të KLGJ-së të vitit 2022.

Gjatë vitit 2022 (që është i vjetër, dhe në fakt gjendja është një çik më e përkeqësuar) raporti kohor i mbarimit të një çështjeje ishte 8,680.4 ditë. Do të thotë 14.6 % më gjatë se në vitin paraardhës. Po sot sa është?

Njëkohësisht, ju e thatë që në vitin 2022 ishin 21.166 çështje të regjistruara. Por mos harroni, nuk u përmend që 10 % e këtyre çështjeve kishin më shumë se 5 vjet. Sa çështje më shumë se 5 vjet që presin të gjykohen, ka aktualisht? Nuk u tha. Nuk është faji... sepse raporti është shumë dinamik dhe statistikën ndonjëherë të gënjejnë në qoftë se nuk i përdor imputet siç duhet me outputet.

Mund të themi që janë regjistruar çështje të reja në 2022 – 3.641 çështje dhe tani

ka ulje. Po a është marrë parasysh bllokimi i gjykatës së shkallës së parë administrative?
Nuk është marrë parasysh.

Nuk është kritikë. Ka të bëjë me sa delikate është mënyra e punimit statistikor. Prandaj unë si avokat që kam qenë dhe përfaqësues ndoshta një çik më afër me vokacionin publik, me të dhënat bruto shqisore dhe me ndjeshmërinë që unë kam pasur në pritshmërinë e çështjeve të vjetra, aq sa ka ndodhur që kemi humbur edhe kontaktet me palët për shkak të kohëzgjatjes shumë të gjërë të tyre, mendoj që numri i gjyqtarëve, jo vetëm jam dakord me ato çka tha parafolësja dhe parafolësit e tjerë, por mendoj se numri duhet të jetë akoma edhe më i lartë dhe duhet të shkojë në 25 gjyqtarë sepse raporti cilësi – shpejtësi është një raport shumë delikat. Pra nuk mund të gjykoj në mënyrë “konvejer”/industriale çështje të cilat kërkojnë në fakt edhe përqendrimin e gjyqtarit, dhe cilësinë e gjyqtarit, dhe rritjen e besimit në publik, dhe të perceptimit të publikut në organet e drejtësisë. Pra ne si vendimmarrës në këtë rast, unë po sjell këndvështrimin tim dhe pikëpamjen time që Gjykata e Apelit Administrativ ka qenë një nga pikat më problematike të sistemit, madje është marrë shpeshherë edhe si model i dështuar sepse bllokimi në Gjykatën e Apelit Administrativ ka ndodhur para vetting-ut. Pra është i hershëm. Pra dy vjet mbas krijimit të gjykatave administrative.

Pra përfundimisht edhe me këtë numër që unë propozoj, 25 gjyqtarë, unë mendoj që përsëri nuk do të ketë garanci. 10 vjet – edhe këtë statistikë po ju them – me raportin e KLGJ-së që ka shkuar para Kuvendit, është dashur pra 10 vjet të mbarojë stoku i çështjeve që ishin në vitin 2022, pa ardhur çështjet e reja, pa marrë parasysh skenarin e ardhjes së çështjeve të reja, të cilat nuk dihen, pra është një variabël (në statistikë quhet variabël kjo), është një variabël i panjohur. Trendi mund të jetë shumë i rrezikshëm. Unë them që edhe 25 gjyqtarë, duhet të kemi një studim më të kalkuluar, mund të mos jetë i mjaftueshëm. Por të paktën të kemi një rritje cilësore të trupave të Gjykatës së Apelit Administrativ.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Tabaku!

Ka diskutime?

Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Atëherë, pasur parasysh dhe sa folën parafolësit në lidhje me propozimet e tyre, unë siç e shpreha i qëndroj kërkimit apo propozimit i cili është paraqitur nga grupi i punës sepse u referua që të dhënat statistikore nuk janë marrë, nuk ka qenë një studim i tillë. Të dhënat statistikore (për të sqaruar) janë marrë nga gjykata dhe numri i çështjeve të regjistruara është marrë nga sistemi, janë paraqitur nga vetë gjykata administrative. Edhe për sa i përket numrit... se kanë ndryshuar ligjet. Po, kanë ndryshuar ligjet, por kanë ndryshuar edhe ligjet kur janë hequr numri i çështjeve të regjistruara. Pse? Sepse ndaj shumë çështjesh, disa çështjesh, në ndryshim nga 2013, në ndryshim nga 2016, i është hequr e drejta e ankimit në gjykatën e apelit. Pra siç është rritur, me ligje të ndryshme, edhe është zvogëluar. Dhe ajo që duket, duket nga të dhënat statistikore, jo nga perceptimi që ne kemi nga jashtë, jo nga perceptimi që ndodhin për shkak të situatave që ne kemi, por e tregojnë të dhënat statistikore. Pra e vetmja e dhënë objektive që kemi neve, është të dhënat statistikore. Dhe analiza është bërë mbi bazën e të dhënave statistikore të regjistruara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, më falni, apelit administrativ, jo mbi bazën si kanë ndryshuar ligjet. Ligjet kanë ndryshuar, patjetër. Dhe këto janë të regjistruara në gjykatë. Janë të gjitha llojet e çështjeve të cilat janë regjistruar në gjykatë. Ne nuk themi për shkak të perceptimeve. Por kur bëhet një analizë, bëhet mbi atë që ne kemi të dhëna statistikore. Normalisht kur bëhet një propozim, referohet mbi bazën e të dhënave statistikore apo mbi bazën e të dhënave objektive, jo perceptimeve. Sepse ne duhet të jemi të matur për të përcaktuar numrin e gjyqtarëve, se nuk është ndonjë numër që ndryshon. Patjetër që ndryshon, e ka thënë ligjvënësi, ndryshojë çdo 5 vjet. Ne mund të themi shumë mirë pse ka ndryshuar...? Po ne kemi ndryshuar numrin e popullsisë në Shqipëri njëherë. Kemi ardhur duke e zvogëluar. Çfarë t'i themi kësaj neve?

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Këtë po them unë, që gjërat ndryshojnë. Nuk nisemi nga atë që ne kemi perceptim, por si ndryshojnë gjërat. Dhe gjërat shikohen nga të dhënat statistikore. Analiza është bërë nga të dhënat statistikore dhe mbi ato të dhëna të paraqitura nga vetë gjykatat. Nuk i kemi marrë ne të dhënat. Janë paraqitur, i janë kërkuar vetë gjykatave, dhe kanë dhënë të dhëna statistikore në bazë të atyre që ato kanë të regjistruara. Thashë

kanë bërë ndryshime. Mos i krahasoni me vitin 2013, edhe me 2016. Pse? Ka ndryshuar situata.

Thashë që në vitin 2010... të lutem. Backlog-u është krijuar që në 2013, që me vendimet unifikuuese në 2014, që ka shkuar në 10.000 numri i çështjeve të regjistruara. Po them që nga 2013 deri tani ka ardhur gjithmonë duke u ulur, për shkak edhe të ndryshimeve ligjore, ku futet edhe ligji jonë, -se u përmend ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Patjetër. Këto janë numri i çështjeve të regjistruara të cilat aktualisht janë llogaritur. Aq sa janë regjistruar deri tani. Se ne nuk parashikojmë sa regjistrohen. Ne shikojmë trendin. Si shkon trendi. Trendi ka ardhur duke u ulur. Mund të shkojë duke u rritur. Patjetër. Ne do propozojmë rritjen më pas. Por trendi, edhe për shkak të ndryshimeve ligjore të cilat ne kemi propozuar si grup pune, nuk e di si do miratohen, absolutisht. Se në qoftë se do miratohen ato, ato që ne kemi propozuar, do shkojë duke u ulur akoma edhe më shumë. Pse? Se si në apelin e përgjithshëm dhe apelin administrativ, ne kemi propozuar uljen e numrit të çështjeve për të cilat bëhet ankim. Aktualisht janë ulur. Ne po i referohemi trendit, aktualisht. Kemi ndryshuar edhe për shkak të vendimeve unifikuuese. Për shembull një nga vendimet njësuuese ka qenë për Gjykatën Administrative që i ka futur çështjet ndaj të cilave nuk lejohet ankim, edhe kundërshtimet... po pra... titujt ekzekutiv, që më përpara lejoheshin në apel. Pra po zvogëlohet numri i çështjeve. Dhe kjo shikohet nga të dhënat statistikore. Ne nuk nisemi nga perceptimet. Dhe kur llogaritet numri i gjyqtarëve, nuk llogaritet mbi backlog, nuk llogaritet mbi numrin e çështjeve të cilat kanë ngelur backlog. Backlog-u siç e thamë ka ndodhur për shumë situata në gjykatën administrative. Dhe nuk mund ta them unë që është dështim gjykata administrative. Nuk është një parashikim i mirë nga ligjvënësi, por jo nga gjyqtarët. Pse? Sepse në 2014 u parashikua një gamë e caktuar çështjesh dhe u parashikuan 7 gjyqtarë. Ndryshoi vendimet unifikuuese, shkuan në 13 në 2016. Aktualisht shkoi një rritje e numrit të çështjeve që regjistrohen por me ndryshimet e fundit, edhe në K.Pr.Civile edhe në ligjin për gjykimin administrativ ka ndryshuar, të cilët janë ulur numri i çështjeve që lejohet ankim. Mos shikoni çështjet që janë regjistruar. Prandaj themi, kur bëhet analiza, bëhet analiza e viteve të fundit të çështjeve të regjistruara. Jo ato që kanë ngelur. Kanë ngelur për shumë arsye. S’kemi pasur gjyqtarë. Kryesorja. Ne po themi ato 13 do shkojnë 19, për shkak të numrit të çështjeve të regjistruara, duke pasur parasysh edhe

kompleksitetin e çështjeve, absolutisht që është pasur parasysh dhe kompleksiteti i çështjeve të regjistruara. Nuk është nisur një analizë e tillë. Thashë, po t'i krahasojmë është numri më i vogël i çështjeve në gjykatën administrative. Duke pasur parasysh, edhe për sa i përket afatit ligjor që është krijuar backlog-u, për këtë nuk është respektuar. Dhe prandaj ne po rrisim me trup gjykues. Është bërë një studim që është e parashikueshme. Atë 22 ne nuk e kemi të parashikueshëm. Nuk e kemi gjë të parashikueshme. Aktualisht ne kemi këtë të parashikueshme. Ndryshon situata. 22 mo, 25, në qoftë se ndryshojnë ligjet.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Po nuk është në lidhje me backlog-un. Atëherë, numri i gjyqtarëve nuk lidhet me backlog-un. Nuk duhet ta lidhim asnjëherë.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Po jo pra, nuk lidhet.

Prandaj them që këto janë argumente që duhet të shkojmë tek 19, sepse në radhë të parë – e fundit, po e përsëris këtë gjë, ju kërkoj ndjesë – ne kur të bëjmë propozimin duhet të kemi parasysh dhe burimet njerëzore. S'i kemi.

Albens Tabaku: Atëherë, unë do shtoja vetëm këtë. Që vetëm me 2023, sikur 13 gjyqtarë të ishin...

Ilir Rusi: Zoti Tabaku është duke folur sepse po bën korrelacion ndërmjet vijueshmërisë së diskutimit së fundmi të zonjës Plaku. Prandaj dhe zoti Tabaku është duke folur.

Albens Tabaku: Po, po e mbyll.

Atëherë, vetëm me raportin e KLGJ-së, po flas me statistikën e KLGJ-së, që çështjet ekzistuese në vitin 2023, me një organikë të plotë prej 13 gjyqtarësh, do duheshin të paktën 10 vjet e gjysmë, -që ju nuk mendoni që duhet llogaritur backlog-u. Me një rregull treshi i bie, po këto që vijnë me skenarët që ende nuk i parashikojmë dot, sa kohë do të duhet për të arritur afatin 30-ditor. Kështu që, përsëri, edhe me 25 gjyqtarë, jo me

perceptim por me statistikë dhe me mënyrën se si futen variablat në studim, dhe kjo është një problematikë e madhe e KLGJ-së, e ka pasur edhe më parë.

Irena Plaku: Studimet, na kanë ndihmuar edhe ndërkombëtarët. Nuk i kemi bërë neve shqiptarët me pak fjalë. E them kot, sa për informacion. Na i kanë bërë ekspertë të huaj të cilët kanë ndihmuar, domethënë ekspertë, që s'kanë pasur asnjë lidhje interesi në Republikën e Shqipërisë, që mund të ndikojnë tek pjesa variable.

Ilir Rusi: Zoti Kurushi, fjala për ju!

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Unë nuk do të marrë shumë kohë.

Vetëm kisha një shqetësim që duhet ta përcjell siç e mendoj unë, shqetësim që lidhet me faktin e disponibilitetit të burimeve njerëzore për Gjykatën Administrative të Apelit. Nëse ne sot miratojmë numrin e gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit, ky numër që e miratojmë sot nuk do na imponojë që nesër të hidhemi në aksion dhe të mbushim vendet e Gjykatës Administrative të Apelit. Po të shikojmë programin strategjik të buxhetit 2025 – 2027, ky është një program afatmesëm, që do të thotë, ne nuk i nxjerrim menjëherë gjyqtarët nga gjykata e shkallës së parë për t'i çuar në gjykatën e apelit, madje edhe propozimet që i bëjmë, nuk i bëjmë në Kuvend për të miratuar numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve dhe numrin e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Administrativ, brenda këtij viti. Programi ynë është program afatmesëm, që do të thotë, mbushja e gjykatës së apelit me pozicionet e reja që ne propozojmë për t'i hapur, do bëhet në mënyrë graduale. Gjatë kësaj kohe, dy vjet, tre vjet, katër vjet. Dhe unë jam i bindur që ne nuk kemi as mundësi që t'i bëjmë brenda 1 viti gjyqtarët, edhe sikur t'i kemi burimet njerëzore ashtu siç i kërkon ligji. Ne brenda një viti nuk i çojmë dot atje në apel, se e ka treguar përvoja jonë që nuk i kemi çuar dot brenda një viti në apel. Në këtë rast po e them që në ndryshim nga situatat e tjera ne kemi miratuar programin afatmesëm buxhetor 2025 – 2027 (me 19). Dhe kjo do të thotë që në afatmesëm ne nuk do të çojmë 19 (+ 6) menjëherë. Do marrim e do i çojmë në mënyrë graduale. Në mënyrë të integruar. Dhe jam i bindur që gjatë gjithë asaj kohe që ne do bëjmë planin tonë mbi ngritjen në

detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit, kjo detyrë do mbarojë në mënyrë graduale. Brenda një kohe të arsyeshme. Që unë nuk besoj se do jetë një vit. Dy vjet, tre vjet, ndoshta edhe katër vjet. Mund të na hajë më tepër kohë.

Kështu që në këtë pikë unë vazhdoj që t'i qëndroj propozimit tim. Burimet njerëzore janë dhe do t'i kemi në dispozicion për dy-tre vite të ardhshme. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Në vijim të relacionit, në vijim të diskutimeve dhe në referencë të asaj çfarë është thënë në mbledhjen e muajit maj në të cilën është miratuar raporti vlerësues në lidhje me uljen e çështjeve të prapambetura për rritjen e numrit të gjyqtarëve, atëherë edhe sipas formatimit të relacionit, kemi një numër 19 magjistratë gjyqtarë për të shkuar, për t'u rritur gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Administrativ sipas raportit vlerësues, por ndërkohë ka edhe një mendim alternativ në numrin 22 magjistratë gjyqtarë për t'iu propozuar për rritje në lidhje me Gjykatën e Apelit Administrativ. Meqenëse kemi një projeksion rritës, atëherë në vijim, po hedhim në votim propozimin për rritjen e numrit 22 në Gjykatën e Apelit Administrativ, e cila në eventualitet do të reflektojë në rritjen numrit të përgjithshëm të magjistratëve si një propozim i ardhur nga z. Kurushi.

Atëherë, zoti Kurushi ka propozuar numrin 22, dhe e hedhim në votim.

Atëherë, në vijim, dhe duke reflektuar mbi çfarë është thënë, por duke saktësuar terminologjinë e përdorur, do t'i kërkoja z.Tabaku, që është opinion apo propozim numri matematikor që nga ana juaj u përmend përgjatë diskutimit tuaj?

Albens Tabaku: Është propozim, 25 gjyqtarë. Jo opinion.

Ilir Rusi: Atëherë, kemi tre propozime: 19, 22, 25.

Do kalojmë tek 25 dhe pastaj vazhdojmë më tej.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Po pra, sepse kemi tre propozime. 25 – është z. Tabaku; 22 - është zoti Kurushi; dhe 19 – është raporti vlerësues. Po hedhim numrin matematikor më të lartë, 25, si një propozim për rritje të numrit të magjistratëve në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër. I qëndroj propozimit të grupit të punës për rritjen e numrit të gjyqtarëve administrative të apelit nga 13 në 19. Argumentat i tha zonja Plaku. Nuk po zgjatem më tej. Faleminderit!

Bledar Bajri: Kundër.

Albens Tabaku: Pro.

Markelian Koça: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

Atëherë, propozimi për të rritur me 25 numrin e magistratëve të Gjykatës së Apelit Administrativ u rrëzua me votim.

Ilir Rusi: Kalojmë tek propozimi tjetër që ka të bëjë me numrin 22 të Gjykatës së Apelit Administrativ. Në eventualitet të kësaj, do reflektojë në rritjen...

Irena Plaku: Atëherë siç e bëra edhe diskutim më përpara, unë i qëndroj propozimit me numër 19, kjo referuar analizës së bërë, e cila nuk lidhet as me një supozim të mundshëm për ndryshimin e situatave apo për llojin e gjykimit të cilat janë marrë parasysh në studimin. Kështu që unë i qëndroj propozimit të ardhur prej 19 gjyqtarësh dhe jo 22. Po pra, e thashë, kundër.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Kundër. Argumentat i thashë më sipër.

Bledar Bajri: Kundër.

Albens Tabaku: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, sapo u miratua me shumicë votash propozimi për rritjen në numër 22 të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Administrativ e cila reflekton në rritjen e numrit të përgjithshëm të magjistratëve. Aktualisht sipas organikës është 408 numri i përgjithshëm i magjistratëve, duke qenë që kjo matematikë rezulton me një rritje prej 9 gjyqtarësh, rezulton që ne duhet të propozojmë propozimin për rritjen e numrit të përgjithshëm të magjistratëve në organikë nga 408 në 417.

Irena Plaku: Atëherë, unë duke qenë se votova kundër për numrin 9 me rritjen nga 6 në 9, unë i qëndroj propozimit domethënë duke arritur në numrin 415 dhe jo 419 (*lapsus numri 419 i referuar nga znj. Plaku ashtu si edhe numri 415*), 414 më fal. Kështu që jam kundër propozimit për rritjen me numrin që u propozua.

Gentiana Muçaj: Unë jam dakord.

Ridvan Hado: Edhe unë kundër, me të njëjtat argumenta që tha zonja Plaku. Faleminderit!

Bledar Bajri: Kundër.

Albens Tabaku: Albensi është pro. Dhe do mblidhemi prapë për ta rritur përsëri numrin e gjyqtarëve. Këtu jemi.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Edhe Klodiani është dakord për propozimin e fundit për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në territorin e Republikës së Shqipërisë në 417. Faleminderit!

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Të propozojë rritjen e numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit nga 13 në 22 gjyqtarë.

2. Të propozojë rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë nga 408 në 417 gjyqtarë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Atëherë, meqenëse kemi shumë pika për të shqyrtuar dhe në referim të këtyre diskutimeve të deritanishme. 5 minuta pushim.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr.242 datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

27

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.10.2024 (Pika 2)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.*
- 6. Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë deri në pikën 9).*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr.242 datë 24.05.2023, për kandidaten *znj. {...}*”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Atëherë, të nderuar anëtarë!

Në vijim të kësaj mbledhjeje po vazhdojmë me një pikë tjetër. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr.242 datë 24.05.2023, për kandidaten *znj. {...}*”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, pa humbur kohë po filloj me relatimin për tërheqjen e zonjës {...} nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.242 datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Shkurtimisht po e prezantoj. Zonja {...} ka shprehur interes dhe ka kandiduar në pozicionin nr. 242 të hapur me vendimin me të njëjtin numër si pozicion i lirë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin e datës 24.05.2023. Afati i kandidimit ka qenë data 14.06.2023 si afat i fundit i saj.

Situata e zonjës {...} ka pasur një historik që fillimisht ajo nuk është përfshirë në procedurat e verifikimit të kriterëve formale sepse Këshilli në atë kohë vlerësoi që ajo kishte më tepër sesa tre kërkesa në proces ngritjeje në detyrë dhe lëvizje paralele.

Zonja {...}, këtë vendim të Këshillit për mospërfshirjen në procedurat e verifikimit të kriterëve formale e kundërshtoi në gjykatë. Gjykata e Apelit Administrativ i pranoi padinë zonjës {...} dhe më pas, palët e tjera të interesuara kundërshtuan vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ në Gjykatën e Lartë.

Gjykata e Lartë përfundimisht vendosi pranimin pjesërisht të padisë së zonjës {...}, duke pranuar hapjen e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore, për pozicionin nr. 242, pozicion i cili bëhet fjalë në kërkesën për tërheqjen dorë prej zonjës {...}.

Çfarë ndodhi më pas?

Më pas, në fazën ku ndodhej procesi që ishte faza e përfundimit, për një kandidate, të dy vlerësimeve (zonjës {...}), zonjës {...} i kishte përfunduar, i kishte ezauruar, i kishte përmbushur, i kishte mbyllur të dy proceset e vlerësimit, zonja {...} bën një kërkesë për heqjen dorë, pra tërhiqet nga pozicioni nr. 242. Arsyeja e tërheqjes lidhet me faktin që (e thotë vetë në shkresën e saj) se ajo në sistemin e pikëzimit ndodhej më poshtë sesa zonja {...} dhe kjo është arsyeja pse unë heq dorë nga vijimi i procedurës. Procedurë e cila për të dhe për Këshillin do ta zgjaste më tej në kohë situatën e procesit të përzgjedhjes dhe të renditjes së kandidatëve, sepse do fillonte verifikimi i të gjitha kriterëve ligjore për zonjën {...}.

Ajo në këtë pikë tha që unë tërhiqem nga kërkesa e bërë për pozicionin nr. 242 dhe në fund fare, ndodhur në këtë situatë, Komisioni përgatiti projektvendimin përkatës, ku i propozon mbledhjes së sotme përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 242 datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

Një kopje e vendimit t'i njoftohet kandidates si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky ishte propozimi ynë i radhës.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime. Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr.242 datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

3.1 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.2 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}”.

3.3 “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}”.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |

32

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.10.2024 (Pika 3)***

7. *Albens Tabaku* (anëtar)
8. *Yllka Rupa* (anëtare)
9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.*
6. *Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë deri në pikën 9).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

3.1 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3.2 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}”.

3.3 “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}”.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit në lidhje me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}; Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}.

Për më tej fjalën z. Kurushi, sepse është një relacion i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Zoti Koça, në shqyrtimin e kësaj pike, nuk do të jetë prezent.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Për shkak të koherencës që kanë projektvendimet me njëra-tjetrën, janë tre projektvendime, i kemi paraqitur në një relacion të tria projektvendimet.

Projektvendimi i parë për zonjën {...} ka të bëjë me propozimin që ne i bëjmë mbledhjes për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023, pasi në këtë pozicion zonja {...} është kandidatë e vetme.

Më pas, meqenëse është kandidatë e vetme dhe thashë projektvendimet ndjekin në koherencë njëra-tjetrën, paraqesim projektvendimin e dytë të radhës që ka të bëjë me ngritjen në detyrë të gjyqtares znj. {...} në Gjykatën Administrative të Apelit si kandidatë e vetme. Dhe projektvendimi i tretë ka të bëjë me propozimin për përfundimin përpara afatit të shërbimit në skemën e delegimit për gjyqtaren znj. {...}, pasi me ngritjen në detyrë të saj, skema e delegimit nuk ka më objekt dhe mbetet e pamundur për t'u praktikuar/ushtruar nga zonja {...}, pasi ajo do shkojë në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Pa humbur kohë po paraqes në mënyrë sintetike rezultatet e relacionit që ne kemi përgatitur.

Shkurtimisht për pozicionin nr. 235, datë 24.05.2023 kanë paraqitur kërkesë në atë kohë, përveç zonjës {...} dhe disa kandidatë të tjera, siç ishte zonja {...}, zoti {...}, dhe zoti {...}.

Në datën e vendimmarrjes mbi fillimin e procedurave të verifikimit të kritereve ligjore për këtë pozicion, pra në datë 07.02.2024, Këshilli verifikoi vetëm tre kandidatë fillimisht që kanë qenë kandidatë për këtë pozicion, që kanë qenë znj. {...}, zoti {...} dhe zonja {...}.

Këshilli për këtë pozicioni arriti në konkluzionin se z. {...} nuk kishte aplikim të vlefshëm, pasi sipas llogaritjeve që kishte bërë Këshilli në atë kohë, rezultonte që në proces z. {...}, në kohën e paraqitjes së kësaj kërkesë kishte katër të tilla. Më tej zoti {...} kundërshton vendimin e Këshillit në Gjykatën Administrative të Apelit. Gjykata Administrative e Apelit më pas vendosi detyrimin e palës së paditur Këshilli i Lartë Gjyqësor për përfshirjen e paditësit në listën e kandidatëve ndaj të cilëve ka filluar procedura e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për pozicionin me nr. 235.

Mbi rekursin e Këshillit, Gjykata e Lartë, me vendimin datë 19.09.2024 vendosi: “Ndryshimin e vendimit nr. 28, datë 27.03.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe rrëzimin e padisë.”

Pas kësaj vendimmarrjeje të Gjykatës së Lartë, aplikanti {...}, me kërkesën nr. {...}, datë 24.09.2024 ka deklaruar para Këshillit heqjen dorë nga kandidimi për vendin vakant në Gjykatën Administrative të Apelit, shpallur me pozicionin nr. 235/2023. Në rrethanat e mësipërme të vendimmarrjes nga Gjykata e Lartë, kemi konkluduar që kërkesa e z. {...} për heqje dorë mbetet pa objekt pasi thamë që Gjykata e Lartë në këtë rast konfirmoi qëndrimin e mbajtur më herët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Gjatë procedurës së verifikimit, dy kandidatët e tjerë në pozicionin nr. 235/2023 konkretisht z. {...} dhe znj. {...} paraqitën kërkesë për heqje dorë nga ky pozicion. Në vijim të këtyre kërkesave, Këshilli, me vendimet e vitit 2024, ka vendosur: “Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, të vitit 2023, për të dy kandidatët, pasi të dy kanë paraqitur kërkesë për t’u tërhequr nga kandidimi për këtë pozicion.

Ndërkohë, kandidatja e vetme e mbetur në këtë pozicion ishte zonja {...}. Ajo ka kandiduar edhe për pozicione të tjera të lira të shpallura me vendimet nr. 504, të vitit 2022 në fushën e të drejtës penale dhe nr. 238, të vitit 2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në fushën e së drejtës administrative, procedura të cilat po vijojnë dhe janë në fazën e verifikimit të tyre në Këshill.

Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret ligjore, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimin, në rastin konkret për të vetmin kandidat, të kriterëve të mëposhtme ligjore, përvojës profesionale minimale e cila kërkonte jo më pak se 7 vjet në Gjykatën e Shkallës së Parë, nga të cilat jo më pak se 5 vjet në fushën e së drejtës administrative, kriter i cili është i plotësuar nga zonja {...}; kriteri i dytë lidhet me mospasjen e masës disiplinore sipas pikës 8, neni 48 e ligjit ‘Për statusin’; i treti i mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale, neni 8 i ligjit ‘Për statusin’; i katërti, kriteri i pasurisë dhe i figurës, sipas pikave 7 dhe 8 të nenit 48 të ligjit ‘Për statusin’.

Për kandidaten znj. {...}, Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve formale të kandidimit me vendimin nr. 114, datë 06.03.2024; ndërsa me vendimin nr. 350, datë 09.07.2024 vendosi kualifikimin e saj për dy pozicionet e lira ku ajo kishte kandiduar.

Krahas procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidaten janë kryer edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht:

i) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën 2013-2016; ii) vlerësimi i përshtetshëm për vitin 2021, referuar nenit 97, të ligjit “Për statusin”.

Me kualifikimin e kandidates, bazuar në pikën 24, të vendimit të Këshillit nr. 70, të vitit 2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë”, Këshilli, me vendimin nr. 537, datë 26.09.2024, filloi procedurat e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit.

Më datë 27.09.2024, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të vendimit 70/2020, kandidatja e kualifikuar u njoftua për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për pozicionin e lirë ku ajo kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit. Në këtë rast kandidatja nuk pati rezerva në lidhje me kërkesat që iu drejtuan asaj, për fillimin e procedurës dhe caktimin e relatorit.

Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të vendimit 70/2020, relatori administroi dokumentacionin përkatës të kandidates, që gjendej në dosjen e saj personale apo në praktikën dokumentare të procedurës së verifikimit. Relatori administroi edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale të saj.

Konkretisht, lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidaten e vetme znj. {...}, u konstatua se:

a) Sipas vendimit të Këshillit nr. 707, datë 04.12.2023, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 398 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional”.

b) Sipas vendimit të Këshillit nr. 727, datë 07.12.2023, kandidatja është vlerësuar për vitin 2022, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 397 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional”.

Dy vlerësimet etike dhe profesionale të kandidates znj. {...} të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 707 dhe nr. 727, të vitit 2023 u konstatuan të jenë bërë vendime përfundimtare, sepse ndaj tyre nuk është paraqitur ankim.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë ngritjeje në detyrë ka kandiduar vetëm 1 (një) kandidat dhe, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve të përparësive sipas përcaktimeve të Kreut IV, të vendimit 70/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit B, Kreu VI, të vendimit 70/2020, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 235, të vitit 2023.

Projektvendimi është i strukturuar në tre pika dhe i bashkëlidhet relacionit që ne kemi përgatitur për renditjen e zonjës {...}.

Nuk mendoj se duhet ta lexoj edhe projektvendimin sepse është përpara dhe besoj se kolegët janë të azhurnuar me përmbajtjen e saj.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Sikundër edhe u prezantua nga relatori, ky relacion ka tre nënndarje. Jemi tek pjesa e parë e saj, që ka të bëjë me “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Ka diskutime?

Nuk ka diskutime. Vazhdojmë në votim.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Sikundër e thamë, ka disa pika ky rend.

Vazhdojmë me pjesën që ka të bëjë me “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}”.

Zoti Kurushi, fjala për ju.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Në vijim të relacionit, po ndjek radhën për të përligjur edhe propozimin e dytë që ka lidhje me projektvendimin për ngritje në detyrë të zonjës {...} në Gjykatën

Administrative të Apelit për pozicionin nr. 235, të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të vitit 2023.

Në vijim të relacionit që unë parashtrova përpara Këshillit, në funksion të vendimmarrjes mbi propozimin e komisionit për miratimin e renditjes, po vijoj më tej me pjesën tjetër të relacionit që ka lidhje me propozimin për ngritjen në detyrë të kandidatës.

Në kushtet kur zonja {...} rezulton të jetë kandidate e vetme në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe duke vlerësuar se vendimi i Këshillit për miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurat e ngritjes në detyrë me një kandidat të vetëm është një akt tashmë i përcaktuar sepse nuk ka më diskrecion Këshilli, pasi ajo është kandidate e vetme në renditje, nuk ka diskutime, nuk do ketë besoj as kundërshtime apo ankime si kandidate e vetme, ne parashtrojmë propozimin e radhës që lidhet me projektvendimin për ngritjen në detyrë sepse thamë vendimi i marrë është një vendim i përcaktueshëm dhe ky vendim nuk afekton në thelb vijimin e procedurave të mëtejshme për ngritjen në detyrë të kandidatëve në pozicionet e tjera në zbatim të pikës 68 të vendimit nr. 70 të vitit 2020. Relatori në këtë rast i procedurës së përzgjedhjes përgatiti projektvendimin për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, 24.05.2023.

Projektvendimi i propozuar titullohet “Për ngritjen në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, znj. {...}”.

Projektvendimi është i strukturuar në tre pika.

Pika e parë e projektvendimit bën fjalë për ngritjen në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit të znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohen edhe efektet juridike të tij.

Atëherë, unë këtu propozoj meqenëse në projektvendim thuhet që efektet juridike fillojnë menjëherë. Propozimi që unë bëj sot përpara Këshillit është: Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 10.10.2024”. Sot jemi më datë 9. Fillojnë nesër. Menjëherë i binte të fillonte sot, por duhet të fillojnë të nesërmen.

Njëkohësisht është edhe një datë e nesërme që do na shërbejë edhe për propozimin e radhës “Për përfundimin e skemës së delegimit”. Domethënë duke filluar nesër ky propozim, nëse ne ia bëjmë edhe njoftimin sot për nesër, në mënyrë

elektronike, atëherë ditën e nesërme ajo fillon funksionin si gjyqtare permanente në Gjykatën Administrative të Apelit dhe njëkohësisht ditën e nesërme fillojnë edhe efektet e përfundimit të skemës së delegimit të saj në Gjykatën Administrative të Apelit. Prandaj kjo është arsyeja pse ne propozojmë “Efektet juridike të fillojnë më datë 10.10.2024”, pra ditën e nesërme.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime, duke vlerësuar sqarimet e bëra së fundi nga zoti Kurushi, në ndryshim nga ai projekt-akt që ishte?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në miratimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit të zonjës {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit me përditësimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Sikundër u tha, ka edhe një nënpikë tjetër të kësaj pike që ka të bëjë me “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}”.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Gjithashtu relacioni i renditjes në pozicionin nr. 235 të vitit 2023 dhe i ngritjes në detyrë të zonjës {...} është shoqëruar edhe me projektvendimin e radhës, që ka për objekt përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit të zonjës {...}.

Këshilli pas kërkesës së zonjës {...}, me vendimin nr. 366, të vitit 2023, ndër të tjera vendosi pranimin e kërkesës së gjyqtares {...}. Caktimin e saj në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat 3 vite që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

Në vijim, me vendimin nr. 367, datë 13.07.2023 është vendosur: Gjyqtarja e skemës së delegimit zonja {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit për periudhën deri më datë 13.07.2023. Gjyqtarja e skemës së delegimit përjashtohet nga procedurat e shortimit në Gjykatën Administrative të Apelit për periudhën deri më datë 01.09.2023, me përjashtim të çështjeve për të cilët gjyqtarët e kësaj gjykate do të kenë pengesë ligjore për gjykimin e tyre.

Në rrethanat e krijuara me ngritjen në detyrë të zonjës {...}, propozim i cili u miratua tashmë në këtë mbledhje nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, komisioni propozon Këshillit përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit të zonjës {...}, pasi ajo tashmë është gjyqtare e ngritur në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe nuk ka më kuptim, efekt skema e delegimit, pasi kjo skemë është bërë posaçërisht për gjyqtarët që të ushtronin funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në pikën e parë të projektvendimit ne kemi parashikuar përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit për gjyqtaren znj. {...}. Në pikën e dytë parashikohet afati i cili është data në të cilën këshilli do të shprehet për ngritjen në detyrë. Meqenëse ne u shprehëm për ngritjen në detyrë që të fillojnë efektet në datë 10.10.2024, propozojmë që më datë 10.10.2024 (pra në të njëjtën ditë) të përfundojë edhe skema e delegimit për zonjën {...}.

Pikat e tjera janë të njohura.

Kopja e vendimit i njoftohet gjyqtares e cila është pjesë e skemës së delegimit, si dhe Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime, duke vlerësuar edhe përditësimet e bëra së fundi nga zoti Kurushi?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit të përditësuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

4.1 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

4.2 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, znj. {...}”.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |

43

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.10.2024 (Pika 4)***

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.*
6. *Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë deri në pikën 9).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

4.1 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

4.2 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, znj. {...}”.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës që kanë të bëjnë me “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në

44

Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; dhe “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, znj. {...}”.

Më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Situata është e ngjashme. Ne në një relacion kemi bashkangjitur për shkak të kronologjisë së situatës, rrethanat në të cilat është përpiluar relacioni dhe rrethanat në të cilat propozohet edhe projektvendimi, që në një relacion të propozojmë dy projektvendime, të cilat janë rrjedhë logjike dhe zinxhir i procedurave që organizon Këshilli për renditjen dhe ngritjen në detyrë të magjistrates, meqenëse ajo është gjyqtare e vetme e cila kandidon në vendin e shpallur me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 242, datë 24.05.2023, që është pozicioni civil në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Pra e theksoj është gjyqtare e vetme në atë ‘pull’, në atë pozicion. Kjo është arsyeja pse ne bëjmë në një relacion dy projektvendime.

Këshilli, për pozicionin e përmendur më lart nr. 242, datë 24.05.2023 (po e them në mënyrë të shkurtuar), mori në konsideratë fillimisht dy candidate të cilat shprehën interesin e tyre për të kandiduar në këtë pozicion. Ato ishin znj. {...} dhe znj. {...}, të cilën ne e relatuam si një situatë në rastin kur zonja {...} hoqi dorë nga pozicioni nr. 242. Pra është e njëjta situatë që unë nuk po e kaloj ta përsëris edhe një herë.

Pas heqjes dorë të saj, e vetmja në pozicion ka mbetur zonja {...}. Ajo kandidon si candidate e vetme në pozicionin nr. 242, të shpallur me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor të vitit 2023, njëkohësisht ajo kandidon edhe në pozicione të tjera të lira të shpallura me vendimet nr. 244 dhe 247, në të njëjtën datë, pra datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në fushën e së drejtës civile për një pozicion të lirë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit në rastin konkret për të vetmen candidate, të kriterëve të mëposhtme ligjore: përvoja profesionale minimale; mospasja e masës disiplinore në

fuqi; mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale; të kriterit të pasurisë dhe figurës.

Për kandidaten znj. {...} Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve formale të kandidimit dhe me vendimin nr. 110, datë 06.03.2024 vendosi që kjo candidate i ka plotësuar kriteret formale të kandidimit dhe lejoi vijimin e procedurave për verifikimin e kriterëve të tjera ligjore.

Me vendimin e mëpasshëm nr.528, datë 24.09.2024, Këshilli vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për tre pozicione të lira ku ajo kishte kandiduar. Me kualifikimin kuptojmë edhe verifikimin e kriterëve të pasurisë dhe të figurës.

Krahas procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht për kandidaten vijuan edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional. Konkretisht vlerësimi me qëllim gradimi, periudha e vlerësimit 2013-2016 dhe vlerësimi i përshtetshëm për vitin 2022, referuar nenit 97 të ligjit “Për statusin”.

Me kualifikimin e kandidates, bazuar në pikën 24 të vendimit 70, të vitit 2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli me vendimin nr. 537, datë 26.09.2024, filloi procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes, u caktua kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Më datë 27.09.2024, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30 të vendimit 70/2020, kandidatja e kualifikuar u njoftua për fillimin e procedurës së përzgjedhjes si dhe për caktimin e relatorit. Pas njoftimit kandidatja nuk paraqiti kundërshtime në lidhje me procedurën e nisur dhe me caktimin e relatorit.

Lidhur me dokumentacionin që administroi relatori në procedurën e përzgjedhjes. Fillimisht i referohemi vendimeve që ka marrë Këshilli lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidaten e vetme znj. {...}. Është vendimi i Këshillit nr. 503, datë 13.09.2024, kandidatja është vlerësuar, graduar, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 399 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional”. Dhe me vendimin e Këshillit nr. 502, datë 13.09.2024 kandidatja është vlerësuar për vitin 2022, në nivelin e përgjithshëm

“Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 387 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

Dy vlerësimet etike dhe profesionale të përmendura më lart janë verifikuar dhe nga verifikimi është konstatuar se ato janë bërë përfundimtare sepse ndaj tyre nuk është paraqitur ankim.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në procedurën e ngritjes në detyrë ka vetëm 1 (një) kandidat dhe, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve dhe përparësive të tjera sipas përcaktimeve të Kreut IV, të vendimit 70/2020, në funksionin e renditjes së kandidatëve.

Projektvendimi në këtë rast është i strukturuar në tre pika dhe ndër to do t'i propozohet nga Komisioni, Këshillit, në mbledhjen e sotme, të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: një dhe e vetme në renditje për këtë pozicion është zonja {...}.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Në vijim, zoti Koça është rikthyer në shqyrtimin e këtyre pikave.

Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me projektvendimin “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, znj. {...}”.

Zoti Kurushi fjala për ju.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Atëherë po vijoj relacionin për të përlegjur edhe arsyet pse kemi dërguar projektvendimin e dytë për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë dhe më pas për propozimin për ngritjen në detyrë të gjyqtares zonjës {...}.

Më duhet të sqaroj që projektvendimi për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e muajit tetor të vitit 2024, sikurse përcaktohet në seksionin C, kreu VI i vendimit 70/2020, ku pasi ka konstatuar si të plotë dokumentacionin e administruar për kandidaten në këtë procedurë përzgjedhjeje, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Komisioni për këtë çështje përbëhej nga anëtarët e përhershëm z. Klodian Kurushi dhe z. Albens Tabaku

si dhe anëtarja zëvendësuese zonja Emona Muçi, pasi anëtari i përhershëm zoti Markelian Koça ka pasur papajtueshmëri në këto procedura.

Zonja Muçi si ish-anëtare e KVEVP-së, pra Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale, ka qenë relatore në vlerësimin e përsheptuar për vitin 2022 të zonjës {...} në përputhje me parashikimet e nenit 67 të ligjit nr. 115/2016 si dhe të vendimit nr. 21/2008 të Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet ndër të tjera se në konkurrim të parimit të ushtrimit të funksionit të organit shtetëror dhe të paanshmërisë, merr përparësi ai i kryerjes së funksionit kushtetues, në këtë rast është konkluduar se zonja Muçi nuk ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë për të shqyrtuar vendimmarrjen paraprake në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës.

Në kushtet kur kandidatja zonja {...} (sepse është e njëjta situatë edhe për projektvendimin e dytë), në kushtet kur zonja {...} rezulton të jetë kandidate e vetme në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke vlerësuar se vendimi i Këshillit për miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë me një kandidat të vetëm që ne e vlerësuam është me natyrë përcaktuese, që nuk afekton në thelb vijimin e procedurave të mëtejshme për ngritjen në detyrë të kandidatëve në pozicione të tjera, në zbatim të pikës 68 të vendimit të vendimit 70/2020, relatori i procedurës së përzgjedhjes përgatiti projektvendimin për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 242, të vitit 2023, të kandidates së vetme znj. {...}.

Projektvendimi i propozuar titullohet “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, znj. {...}”.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika të cilat janë pjesë integrale e relacionit dhe projektvendimit bashkëlidhur.

Në pikën e dytë të projektvendimit, pasi pika e parë bën fjalë për ngritjen në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm zonjës {...}. Në pikën e dytë ne kemi lënë bosh ditën se kur do të fillojnë efektet juridike të këtij vendimi, pra të vendimit të ngritjes në detyrë. Unë propozoj që data e fillimit të efekteve të këtij vendimi për ngritjen në detyrë të gjyqtarës zonjës {...} në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të jetë data 21.10.2024, pra afërsisht një 10 ditë kohë. Do

jetë një kohë e mjaftueshme për zonjën {...} për të përfunduar të gjitha ato detyrime që lidhen me administrimin, dorëzimin e dosjeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në këtë datë të fillojnë funksionet e saj si gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ky është propozimi.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime në lidhje me përditësimin, sipas të dhënave së fundmi të shprehura nga zoti Kurushi?

Nuk ka. Vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.**
- 6. Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë deri në pikën 9).**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtarës *znj. {...}*”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtarës *znj. {...}*”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Më datë 07.10.2024 është administruar në Këshill kërkesa e Gjykatës Administrative të Apelit protokolluar me aktin nr. 3844 “Kërkesë për caktim gjyqtarësh nga skema e delegimit”.

Më datë 29.02.2024, gjyqtarja *znj. {...}* ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor formularin e kandidimit për pjesëmarrjen në skemën e delegimit, nëpërmjet të cilit ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Shprehja e interesit për të shërbyer në skemën e delegimit është bërë sipas njoftimit publik të Këshillit të shpallur në faqen zyrtare të tij.

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, konstatohet se znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 02.07.2001, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2007 si dhe ka përfunduar studimet Master të Nivelit të Dytë në “E drejtë Civile”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2011.

Me dekretin nr. 5051, datë 04.10.2006 të Presidentit të Republikës ajo emërohet gjyqtare dhe caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Me dekretin nr. 5515, datë 14.11.2007 të Presidentit të Republikës caktohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Me dekretin nr. 8254, datë 16.07.2013 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë këtë detyrë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 18 vite.

Znj. {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Vlerësimi i Komisionit:

Neni 45 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullon institutin e skemës së delegimit, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga magjistrati për t’u pranuar në këtë skemë, si dhe detyrimin e Këshillit për të miratuar rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së magjistratëve si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit, duke parashikuar ndër të tjera se:

“1. Magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t’u caktuar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill.

2. Magjistrati shërben në skemën e delegimit jo më shumë se 5 vjet.

3. Magjistrati që kandidon për pozicione në skemën e delegimit, nënshkruan një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t’u caktuar në çdo gjykatë ose prokurori.”

Në zbatim të nenit 45 të Ligjit 96/2016 Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 22 datë 07.02.2019, ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”. Konkretisht, neni 4 i kësaj Rregulloreje parashikon kriteret e kandidimit në skemën e delegimit, si vijon:

“Në skemën e delegimit kandidon çdo gjyqtar që plotëson këto kriteret:

- a. Të ketë dhënë pëlqimin për t’u komanduar në skemën e delegimit;
- b. Të ketë jo më pak se 1 vit përvojë në funksion;
- c. Të mos jetë nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit;
- d. Të mos ushtrojë funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit;
- e. Të mos jetë i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e saj;
- f. Të mos jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim”.

Bazuar në rrethanat e faktit të parashtruara më sipër, në lidhje me parashikimet ligjore të nenit 45 të Ligjit nr. 96/2016, si dhe në lidhje me parashikimet e vendimit nr. 22, datë 07.02.2019, të Këshillit, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, jemi në kushtet e pranimit të përfshirjes së gjyqtarës {...} në skemën e delegimit, pra të caktimit të saj në këtë skemë pasi: gjyqtarja ka dhënë pëlqimin për t’u caktuar në skemën e delegimit; ka më shumë se 1 vit përvojë në funksion; nuk ndodhet nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit; nuk ushtron funksionin e Kryetares apo Zëvendëskryetares; është e caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi nuk cenon funksionalitetin pasi aktualisht rezulton se në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë ushtrojnë funksionin 14 gjyqtarë, ndërsa organika e saj është me 27; nuk rezulton të jetë duke ushtruar funksionin e saj si gjyqtare në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.

Sa më sipër, konkludohet se gjyqtarja {...} plotëson kriteret për t’u caktuar në skemën e delegimit.

Lidhur me situatën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezulton se Këshilli ka hapur aktualisht 5 (pesë) pozicione të lira, për të cilat vijon procedura.

Për 1 nga pozicionet e shpallura në maj 2024, 1 nga konkurrentet me 2 vlerësime, znj. {...} është transferuar përkohësisht në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë.

Komisioni ka filluar verifikimet edhe për konkurrentin tjetër, z. {...}, si konkurrent i kualifikuar për ato pozicione, të ndiqet e njëjta procedurë, transferimi i dedikuar me pëlqim në kuadër të lëvizjes paralele.

Pra, themi, meqenëse ne përfshijmë në skemën e delegimit dy gjyqtare nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, për t'i çuar, për t'i caktuar në funksion të skemës në Gjykatën Administrative të Apelit, këto dy vende ne i zëvendësojmë me dy gjyqtarë të tjerë të cilët janë zonja {...} e cila është e transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Administrativ Tiranë, si dhe do ta zëvendësojmë vendin e mbetur bosh për shkak të ngarkesës me zotin {...} për të cilin do të ndjekim të njëjtën procedurë. Pra vendet që ato lirojnë në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, të plotësohen për shkak të ngarkesës, nga këto dy gjyqtarë të tjerë.

Zonjës Gentiana i kanë filluar efektet tani në muajin shtator. Pra nuk ka filluar akoma t'i llogaritet ngarkesa e saj dhe merr ngarkesën e gjyqtarëve të tjerë.

Ndërsa po paraqesim, po përgatisim edhe relacionin e radhës për zotin {...} i cili aktualisht ushtron funksionet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Për të bërë këtë plotësim mund ta çojmë me skemën e transferimit të përkohshëm me dedikim, pasi siç e kemi thënë, janë dy gjyqtarë të cilët kanë dy vlerësime dhe kanë probabilitete të larta për të shkuar me procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Lidhur me efektet juridike të vendimit, sa i përket vijimi të çështjeve gjyqësore.

Nga informacioni i ardhur në rrugë elektronike nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë rezulton se:

“Për sa i përket gjyqtarës {...} ngarkesa e çështjeve është si vijon:

Dosje themeli 551, nga të cilat 26 çështje të pezulluara, 435 çështje janë në seancë përgatitore dhe 90 çështje janë në seancë gjyqësore. Rivendosje në afat ka 3; kryerje të veprimeve të posaçme 1; ndreqje gabimi 2; disponim ankimi 1 dhe 1 ndihmë juridike.

Nga informacioni i marrë pranë Drejtorisë Juridike, nuk rezulton që kjo gjyqtare të ketë çështje në shqyrtim si e caktuar për të gjykuar në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.

Caktimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat 2-vjeçar, që mund të ndërpritet ose të zgjatet në varësi të rrethanave.

Lidhur me afatin e caktimit në skemë delegimi, propozohet 2 vjet, si afat i zgjatjes tërësore të procedurave të ngritjes në detyrë. Pra ne mendojmë që brenda afatit dyvjeçar mund të marrim në konsideratë edhe përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë, pasi zonja {...} është një nga kandidatet që ka shprehur interes për t'u ngritur në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit. Kjo lidhet edhe me afatin që ne propozojmë të jetë 2 vjet.

Përrjashtimin e znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë që kanë kaluar në seancë gjyqësore. Pra ato që kanë kaluar në seancë gjyqësore do t'i ngarkohen t'i përfundojë zonja {...}, pavarësisht se mund të ushtrojë funksionet në Gjykatën Administrative të Apelit në skemën e delegimit.

Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit të tij.

Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

Emona Muçi: Kam diçka për të diskutuar.

Ilir Rusi: Po zonja Muçi!

Emona Muçi: Në lidhje me skemën e delegimit duhet të mbajmë parasysh edhe mentorimin dhe të fillojë skema e delegimit në fund të tetorit, përderisa për të dy gjyqtaret janë caktuar magistratë pranë tyre. Nuk e di a e keni mbajtur në vëmendje pjesën e mentorimit.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçi.

Arsyet teknike të shkëputjes vazhdojnë domethënë. Kjo është teknologjia e ditëve të sotme.

Tashmë vazhdojmë me z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Atëherë, në lidhje me situatën e paraqitur nga zonja Muçi. Më duhet të sqaroj që pjesa e shqetësimit që zonja Muçi ngre për procesin e mentorimit të kandidatëve që janë aktualisht në vitin e tretë në Shkollën e Magistraturës dhe për të cilët do të bëhet edhe vlerësimi i tyre nga mentorët gjyqtarë dhe afati i përfundimit të procesit të monitorimit për ata që këto dy gjyqtare i kanë në proces monitorimi është fundi i muajit tetor, është një çështje që është e përfshirë në propozimet që ne do bëjmë për fillimin e veprimtarisë dhe vijimin e veprimtarisë së këtyre dy gjyqtareve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Sepse në përfshirjen e këtyre dy gjyqtareve në skemën e delegimit ne kemi propozuar që gjyqtaret e skemës së delegimit do të ngarkohen të përfundojnë të gjitha çështjet që kanë në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë që kanë kaluar në seancë gjyqësore. Siç e thashë edhe më lart zonja {...} ka në seancë gjyqësore 90 çështje. 90 çështje janë një ngarkesë e mirë çështjesh që gjyqtarës {...} do t'i duhet t'i përfundojë jo në muajin tetor ku ne urojmë që t'i përfundojë të gjitha në muajin tetor, por do t'i duhet ndoshta edhe më tepër se sa muaji tetor. Kështu që edhe ky shqetësim është i përfshirë në propozimet që ne kemi bërë në përfshirjen e saj në delegim dhe për vijimin më tej të saj të veprimtarisë

58

si gjyqtare e deleguar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për të cilën ne do propozojmë edhe një afat të gjatë kohor duke marrë në konsideratë edhe situatën e procesit të mentorimit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime. Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.**
- 6. Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë deri në pikën 9).**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares *znj. {...}*”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares *znj. {...}*”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, projektvendimi i radhës ka të bëjë me propozimin që ne si Komision bëjmë për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares *znj. {...}*.

Më datë 07.10.2024 është administruar në Këshill kërkesa e Gjykatës Administrative të Apelit protokolluar me aktin nr. 3844 “Kërkesë për caktim gjyqtarësh nga skema e delegimit”.

Më datë 07.10.2024, gjyqtarja *znj. {...}* ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor formularin e kandidimit për pjesëmarrjen në skemën e delegimit, nëpërmjet

të cilit ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Shprehja e interesit për të shërbyer në skemën e delegimit është bërë sipas njoftimit publik të Këshillit të shpallur në faqen e saj zyrtare të internetit.

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, konstatohet se znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 07.07.1995.

Me vendimin nr. 7, datë 08.02.1996 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet ndihmësgjyqtare efektive në Gjykatën e Rrethit Korçë.

Me vendimin nr. 15, datë 30.05.1998 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Korçë.

Me dekretin nr. 8266, datë 16.07.2013 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë mbajtur më datë 17.04.2019 zgjidhet Zv/kryetare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, funksion të cilin e ka ushtruar deri më datë 17.04.2022 dhe në vijim ka ushtruar funksionin si gjyqtare pranë kësaj gjykate.

Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, mbajtur më datë 17.04.2023 zgjidhet Zv/kryetare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, funksion te cilin e ka ushtruar deri më datë 01.07.2023.

Me vendimin nr. 271, datë 25.05.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të riorganizuar”, nga data 01.07.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku dhe aktualisht ajo ushtron funksionin.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 28 vite.

Znj. {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Vlerësimet e Komisionit:

Janë të njëjta me ato çfarë unë i parashtrova edhe për zonzjën {...}, kështu që nuk po kaloj edhe një herë në përsëritjen e të gjitha rrethanave që janë të njëjta, identike me ato rrethana që ne i parashtruam në relacionin e parashtruar më parë në këtë Këshill për zonzjën {...}.

Kështu që, ndodhur në këto kushte, unë mund t'ju jap vetëm një informacion për sa i përket gjyqtares znj. {...} dhe ngarkesës së çështjeve që ajo ka në shqyrtim.

Dosje themeli ajo ka 580, nga të cilat 30 çështje të pezulluara, 389 çështje në seancë përgatitore, 156 çështje gjyqësore, 5 çështje në konkluzione përfundimtare; Urdhra ekzekutimi ka 40; kërkesa civile ka 2; përjashtim gjyqtari 1 dhe disponim ankimimi 2.

Nga informacioni i marrë pranë Drejtorisë Juridike, nuk rezulton që kjo gjyqtare të ketë gjykuar çështje në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ku ajo ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.

Caktimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në 2 (dy) vjet, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

Lidhur me afatin, Komisioni propozon që ai të jetë 2-vjeçar, duke mbajtur në vëmendje kohëzgjatjen tërësore të procedurave të ngritjes në detyrë.

Përjashtimin e gjyqtares {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë që kanë kaluar në seancë gjyqësore, duke pasur parasysh ngarkesën e përcjellë nga gjykata.

Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit të tij.

Një kopje e tij t'i njoftohet znj. {...} si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime. Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
5. **Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.**
6. **Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë deri në pikën 9).**
7. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me projektvendimin “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Relacioni i radhës lidhet me projektvendimin “Për caktimin e gjyqtares në skemën e delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”. Pra e përfshimë me vendimin e mëparshëm në skemë delegimi dhe tani propozojmë që zonja {...} të caktohet si gjyqtare e skemës së delegimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”. Në

66

eventualitetin e miratimit të këtij vendimi, të cilin ne e miratuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe i propozon Këshillit edhe projektvendimin “Për caktimin e gjyqtarës së skemës së delegimit, znj. {...} në Gjykatën Administrative të Apelit”. Lidhur me këtë të fundit, si shkak për propozimin e këtij projektvendimi është situata në të cilën gjendet Gjykata Administrative e Apelit, e cila aktualisht është në kufijtë minimal të funksionalitetit, ndërsa pranë saj ushtrojnë funksionin 11 gjyqtarë (nga 13 sipas organikës). Vetëm 6 (gjashtë) prej tyre kanë emërimin në atë gjykatë, ndërsa 5 (pesë) gjyqtarët e tjerë i përkasin skemës së delegimit. Për gjyqtaren {...} pritet që mbledhja plenare e ditës së sotme të vendoste ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, vendim i cili është marrë ditën e sotme sepse projektrelacioni dhe projektvendimi është bërë përpara marrjes së vendimit të sotëm për gjyqtaren znj. {...}.

Në një situatë të tillë, Gjykata Administrative e Apelit vijon të jetë në nevojë për pasjen në vijimësi në detyrë pranë saj edhe të gjyqtarëve të tjerë, çka do të mundësonte gjykimin e çështjeve të regjistruara përpara saj, numër ky i konsiderueshëm.

Informacioni në vijim, përmban raportimet nga gjykata për tremujorin e dytë të vitit 2024.

Këtu kemi tabelën ku janë të përcaktuara numri i çështjeve të mbartura në vitet e më përparshme për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Administrativ; numrin e çështjeve të reja të regjistruara; numrin e çështjeve të gjykuara; dhe numrin e çështjeve në shqyrtim.

Vlerësimi i Komisionit:

Meqenëse gjyqtarja znj. {...}, në supozimin e miratimit nga Këshilli të projektvendimit të cilin ne e miratuar “Për caktimin në skemën e delegimit”, do të jetë gjyqtarja më e re e skemës së delegimit, ndërsa 5 gjyqtarë të tjerë të skemës së delegimit janë caktuar tashmë nga Këshilli për plotësimin e nevojave imediate të Gjykatës Administrative e Apelit, ne sot vijojmë procedurat e mëtejshme për caktimin e gjyqtarës znj. {...} si gjyqtare e skemës së delegimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

Lidhur me këtë situatë vlen të theksohet se zonja {...} ka një përvojë prej 18 vitesh, pra ka përvojën minimale profesionale që kërkon ligji neni 47, pika 4 e ligjit nr. 96, të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve”, i ndryshuar, për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit, rrethanë kjo që i jep të drejtë Këshillit ta caktojë atë në gjykatën e apelit

për periudhën e caktimit në skemën e delegimit, sikurse përcaktohet në shkronjën “a”, pika 4, të nenit 45, të këtij ligji.

Projektvendimi është i strukturuar në 5 pika.

Në pikën e parë të projektvendimit ne i propozojmë Këshillit që gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} të caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative e Apelit për një periudhë... E kemi lënë për t’u diskutuar, pa përcaktuar datën. Ne propozojmë datën 10.10.2026. Pra thamë, e futëm në skemë delegimi 2 vjet, në projektvendimin e mëparshëm i cili u bë vendim dhe tani propozojmë që data në skemë për zonzjën {...} në Gjykatën e Apelit Administrativ, të jetë deri në datë 10.10.2026. Sot jemi më datë 9 tetor 2024. Plotësohet afati dyvjeçar më datë 10.10.2026 si gjyqtare e deleguar në Gjykatën Administrative të Apelit.

Pika e dytë e projektvendimit, propozohet që gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} të përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën Administrative të Apelit për një periudhë deri më datë 25.10.2024. Është ajo periudha për të cilën ne po e propozojmë tani, për të cilën ne diskutuam. Përfshin të gjithë situatën duke marrë në konsideratë edhe situatën e mentorimit që kjo gjyqtare ka për kandidatët për magjistratë që janë në vitin e tretë në Shkollën e Magjistraturës. Pra deri në këtë kohë ajo nuk do t’i nënshtrohet shortit në Gjykatën Administrative të Apelit. Pas datës 25 do fillojë të jetë pjesë e shortit për shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit.

Njëkohësisht, pika e 3-të, ngarkohet zëvendëskryetari i Gjykatës Administrative të Apelit për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtares znj. {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

Si dhe efektet juridike të këtij vendimi fillojnë nga data e njoftimit.

Efektet financiare të këtij vendimi, ne kemi propozuar të përballohen nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Gjithsesi kjo mbetet propozim alternativ. Mundet edhe të përballohen nga Gjykata Administrative e Apelit. Ne si të tjerët e kemi kaluar tek Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Gjithsesi, mbetemi në diskutim për ndonjë alternativë tjetër.

Edhe shkalla e parë ka fonde.

Si të doni, ne kemi ruajtur... Si të doni.

Klodian Kurushi: Më falni.

Atëherë, në lidhje me pikën 5 të projektvendimit, unë po propozoj që efektet financiare sipas këtij vendimi të përballohen nga Gjykata Administrative e Apelit.

Ndërsa pika 6, një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së skemës së delegimit, në adresën e saj postare, Gjykatës Administrative të Apelit, dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Faleminderit!

Këto janë propozimet.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime referuar edhe përditësimeve të bëra përgjatë relacionit të zotit Kurushi në lidhje me datën dhe efektet financiare se nga cila gjykatë do të përballohen?

Nuk ka diskutime. Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit të përditësuar përgjatë shqyrtimit të saj në këtë mbledhje plenare.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
5. **Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.**
6. **Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë deri në pikën 9).**
7. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Është e njëjta situatë që unë e prezantova pak më parë për zonjën {...}.

Kështu që, nëse kolegët bien dakord me atë çfarë kemi thënë, mos të biem edhe një herë në përsëritje. Janë të njëjtat rrethana. Është e njëjta situatë dhe janë të njëjtat propozime. Kështu që po kaloj direkt tek propozimi.

Pasi e kemi përfshirë në skemën e delegimit znj. {...}, ne propozojmë caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Propozimi i pikës së parë të projektvendimit lidhet me këtë situatë:

Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative e Apelit për periudhën deri më datë 10.10.2026. Pra është afati dyvjeçar të cilin ne e përfshimë në vendimmarrjen e mëparshme në skemën e delegimit. Afati është 2-vjeçar dhe e propozojmë edhe datën konkrete që është data e përfundimit të afatit të skemës së delegimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

Pika e dytë: Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën Administrative të Apelit për periudhën deri më datë 25.10.2024, me përjashtim të çështjeve për të cilat gjyqtarët e kësaj gjykate do të kenë pengesë ligjore për gjykimin e tyre. Mbahet në konsideratë në këtë propozim edhe shqetësimet e ngritura më përpara nga zonja Muçi në lidhje edhe me procesin e mentorimit të kandidatëve për magjistratë.

Pika e 3-të, ngarkohet zëvendëskryetari i Gjykatës Administrative të Apelit për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarës znj. {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më e lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit të tij.

Pika e pestë ndryshohet, bëjmë propozimin e radhës duke ndjekur të njëjtin standard me atë çfarë ne miratuam më parë në projektvendimin e fundit. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata Administrative e Apelit.

Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës së skemës së delegimit, znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, i Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Këto janë propozimet e radhës.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për këtë projektvendim të përditësuar me këto të dhëna së fundmi të relatorit?

Nuk ka diskutime. Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit të përditësuar përgjatë relatimit në këtë mbledhje plenare.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça):

9.1 “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”;

9.2 “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

75

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.10.2024 (Pika 9)***

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.

6. Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë deri në pikën 9).

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça):

9.1 “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”;

9.2 “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Ilir Rusi: Në vijim, po vazhdojmë me një pikë tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator do të jetë z. Koça, që kanë të bëjmë me hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe një pikë tjetër e këtij rendi ditë “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm

për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Fjala për ju zoti Koça.

Markelian Koça: Faleminderit, zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ju paraqesim dy projektvendime: i pari, “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës” dhe i dyti, “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Meqenëse është e njëjta procedurë dhe bëhet fjalë për të njëjtat afate, ne kemi paraqitur një relacion të përbashkët ku gjatë relacionit do të evidentohen situata specifike për secilin rast.

Rezulton se me vendimin nr. 527, datë 11.10.2023 “Mbi transferimin e përkohshëm të gjyqtareve në disa gjykata” Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur ndër të tjera se “...Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës të gjyqtares znj. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimi”.

Me vendimin nr. 528, datë 11.10.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur ndër të tjera “...Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të përkohshëm në fushën e së të drejtës civile të gjyqtarit z. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin”.

Në vijim ju kemi paraqitur një pasqyrë përmbledhëse të ngarkesës së punës në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm Gjirokastër, ku zoti {...} ka emërimin efektiv, dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit Sarandë ku zonja {...} ka emërimin efektiv.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në kuadër të respektimit të standardeve dhe garancive themeltare në një shtet ligjor për një gjykatë “të pavarur” dhe “të paanshme”, në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore të parimeve, thelbësor për zhvillimin e një procesi

të të rregullt ligjor, midis të tjerash ka edhe konceptin e gjykatës së “caktuar me ligj” si edhe të kalimit të afatit të transferimit të përkohshëm të magjistratëve të sipërcituar dhe për pasojë konkludon t’i propozojë fillimin e procedurave të transferimit të përkohshëm duke vlerësuar njëkohësisht edhe rrethanat e ngarkesës në gjykatat ku ato janë transferuar në mënyrë të përkohshme, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (keni paraqitjen tabelare) dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (keni paraqitjen tabelare po ashtu).

Po ashtu është e rëndësishme të theksohet se afati i transferimit të përkohshëm për zonjën {...} dhe z. {...} përfundon më datë 16.10.2024.

Komisioni vlerëson se nevojat për gjyqtarë në gjykatat ku është bërë transferimi i përkohshëm i këtyre dy gjyqtarëve, pra Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Tiranë nuk mund të plotësohen nëpërmjet përcaktimeve të vendimit nr.30, datë 14.02.2019 “Mbi miratimin e vendimit për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Kjo për shkak jo vetëm të parashikimeve të pikës 2 të këtij vendimi ku parashikohet se: “Ky vendim aplikohet në rast të pamundësisë së zbatimit të neneve 45 dhe 46 të ligjit “Për statusin” por edhe për shkak se ngarkesa e çështjeve për gjyqtar është e tillë që nuk mund të përballohet nga kjo skemë dhe kërkon në mënyrë të detyrueshme aplikimin e transferimit të përkohshëm (sipas nenit 46 të ligjit nr.96 “Për statusin”).

Në këto kushte Komisioni ka vlerësuar se në rastin konkret, për plotësimin e nevojave të paraqitura nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, Këshilli duhet të orientohet në përcaktimet e vendimit nr.23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, të ndryshuar, duke shpallur dy pozicione të lira të përkohshme për transferim pranë këtyre gjykatave, duke u bazuar në faktin e parashtruar më sipër, që nuk ka gjyqtarë të disponueshëm në skemën e delegimit si dhe duke vlerësuar që nuk mund të zbatohen parashikimet e vendimit për caktimin e gjyqtarit për një çështje të veçantë, i cili në çdo rast aplikohet në pamundësi të aplikimit të neneve 45 dhe 46 të ligjit nr.96 “Për statusin”.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura, në vendimet e sipërcituara të KLGJ-së si dhe në referim të vendimit nr.23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së, i ndryshuar, Komisioni vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës do të konsiderohen si “gjykata në nevojë”.

Sipas nenit 3 të rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” miratuar me vendimin nr. 23, 07.02.2019 të KLGJ-së përcaktohet që: “Gjykatë në nevojë” nënkupton gjykatën në të cilën ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cenon funksionimin normal të saj.”

Në vendimin nr.86, datë 11.06.2019, neni 5, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.23, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” është parashikuar ndër të tjera se: “Kur një gjykatë është në nevojë dhe në skemën e delegimit nuk ka gjyqtarë të disponueshëm, me kërkesë të gjykatës në nevojë ose kryesisht, kur vlerësohet se nevoja e gjykatës ekziston dhe plotësimi i saj mund të behet vetëm përmes transferimit të përkohshëm, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm që është i hapur për transferim dhe u bën thirrje gjyqtarëve për të dhënë pëlqimin. Thirrja për aplikim publikohet në faqen e internetit të Këshillit dhe u komunikohet gjyqtarëve nëpërmjet kryetarëve të gjykatave. Thirrja përmban kriteret e transferimit të përkohshëm sipas rastit në fjalë dhe modelin e dhënies së pëlqimit sipas modelit bashkëlidhur rregullores. Nëse nevoja e një gjykate, në të cilën ka të transferuar përkohësisht me pëlqim një gjyqtar, mund të përmbushet sërish vetëm përmes transferimit të përkohshëm, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm duke ftuar, fillimisht, për të dhënë pëlqimin, gjyqtarin që është i transferuar në atë gjykatë, nëse transferimi i tij nuk cenon funksionalitetin e gjykatës ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme. Në një rast të tillë, ky gjyqtar mund të transferohet përsëri përkohësisht në gjykatën në nevojë në rast se jep pëlqimin. Këshilli autorizon Komisionin e Zhvillimit të Karrierës të ndjekë hapat e mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.”.

Nga interpretimi i dispozitave të mësipërme, rezulton se për çdo pozicion të lirë të përkohshëm, me qëllim kryerjen e transferimit duhet të kërkohet pëlqimi i të gjithë gjyqtarëve që plotësojnë kriteret për të në mënyrë të veçantë të atyre që aktualisht janë

transferuar në mënyrë të përkohshëm në atë pozicion (“Në rastin e shpalljes së një pozicioni të lirë të përkohshëm në një gjykatë, në të cilën ka gjyqtar të transferuar përkohësisht me pëlqim, dhënia e pëlqimit i kërkohet fillimisht këtij gjyqtari”).

Në këto kushte, referuar faktit se me vendimin nr. 527 dhe nr. 528, datë 11.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...} dhe z. {...}, janë të transferuar aktualisht në gjykatat përkatëse pra Tiranë dhe Durrës, Komisioni, në përputhje me nenin 6, pika 1, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor, të ftojë gjyqtarët për të dhënë pëlqimin brenda ditës së sotme nga njoftimi i këtij vendimi.

Në këto kushte i propozojmë Këshillit shpalljen e pozicionit të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për transferim të përkohshëm deri në datën 16.10.2025; shpalljen e pozicionit të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për transferim të përkohshëm deri në datën 16.10.2025.

Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit të transferuar aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Durrës, znj. {...} si dhe gjyqtarit të transferuar aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë z. {...}, të cilët ftohen për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

Afati për dhënien e pëlqimit siç e thamë është brenda ditës së sotme dhe ndërkohë për veprimet administrative do të merret administrata dhe Komisioni në mënyrë që të merret pëlqimi me shkrim, pavarësisht se në materialet që ju kemi vënë në dispozicion rezultojnë dhe kërkesat specifike të secilit gjyqtar për përsëritjen e afatit të transferimit si dhe opinioni i gjykatave përkatëse, përkatësisht Gjirokastër dhe Sarandë, të cilët mbajnë qëndrimin që nuk cenohet funksionaliteti i gjykatave.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime. Atëherë hedhim në votim projektvendimin “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Atëherë, ka diskutime në lidhje me projektvendimin “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”?

Nuk ka diskutime. Hedhim në votim projektvendimin.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Sikundër theksoi edhe relatori, ftoj administratën të bëjë njoftimet përkatëse me qëllim për të marrë pëlqimin e magjistratëve.

Duke vlerësuar dinamikën e kësaj mbledhjeje edhe për shkak të pikave që kemi në vijim. Një pushim të shkurtër.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

83

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.10.2024 (Pika 10)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

(Pas 20 minutash pushim rifillon mbledhja plenare.)

Ilir Rusi: Vazhdojmë me këtë mbledhje të ditës së sotme me një pikë tjetër.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024, për kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës paraqesim projektvendimin që u lexua nga ju.

Në relacionin bashkëlidhur ju bëj me dije se me vendimin e datës 20.02.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur 14 procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to me vendimin 73, 78, 83 procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Në këto procedura të lëvizjes paralele afati i kandidimit ishte 01.03.2024.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin nr.83 datë 20.02.2024 kandidoi edhe z. {...} gjyqtar pranë Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, aktualisht i transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, bazuar në bazën ligjore përkatëse cituar në relacion, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

Me vendimin nr. 140, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime. II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat.

Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore”, “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të kandidimit të tij për lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli, me vendimin nr. 195, datë 09.04.2024, ka vendosur:

1. Kualifikimin e z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionin e lirë

në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 73, nr. 78 dhe nr. 83 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë, me vendim nr.205, datë 17.04.2024, mbështetur në bazën ligjore cituar më sipër, si relator të procedurës së përzgjedhjes për pozicionet e mësipërme më kanë caktuar mua.

Në datën 17.04.2024, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75, Kreu VI, të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, kandidati u njoftua për vendimin nr. 205, datë 17.04.2024 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizje paralele, ku ai kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidati nuk paraqiti kundërshtime apo kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

Rezulton se më datë 20.09.2024 z. {...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 83, datë 20.02.2024, në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, protokolluar me aktin nr. {...} prot., datë 20.09.2024, duke parashtruar se: “...deklaroj se tërhiqem nga kandidimi im në procedurën e lëvizjes paralele në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 83 datë 20.02.2024”.

Në këto kushte vlerësohet se duhet të mbyllet procedura për shkak të tërheqjes së kandidatit. Kështu që është përcjellë materiali Komisionit dhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në mbledhjen e datës 25.09.2024 ka vendosur t’ia përcjellë mbledhjes plenare vendimmarrjen për sa më lart.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 489, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Albens Tabaku).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 489, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Albens Tabaku).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me një pikë tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z.{...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 489, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Tabaku.

Albens Tabaku: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Atëherë, në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ju paraqes projektvendimin për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 489, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Është përgatitur edhe relacioni për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele të z. {...}.

Me disa vendime të datës 13.09.2024, Këshilli ka hapur pesë procedura të lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ndër to, me vendimin nr. 489 dhe nr. 490, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për 2 (dy) pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe me vendimin nr. 491, nr. 492 dhe nr. 493, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, për 3 (tre) pozicione të lira në fushën e të drejtës penale.

Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 20.09.2024.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 489, datë 13.09.2024 z. {...} kandidoi edhe është me detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, mbështetur në pikën 9, të vendimit 489/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 506, datë 24.09.2024, Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

Kështu që në vijim, me vendimin nr. 520, datë 24.09.2024, Këshilli ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore për procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 489, ..., 493, datë 13.09.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime.

Më datë 25.09.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele”, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidatin z. {...} u kërkuar dhe u administrua informacioni i veçantë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masave disiplinore në fuqi”, departamenti përkatës, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin në fjalë që përshkruhet më poshtë.

Sa i përket “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, dhe po kështu edhe duke iu referuar gjykatës ku kandidati në fjalë ka ushtruar edhe funksionin e gjyqtarit. Kështu që informacioni është kërkuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Nga rezultatet e verifikimit, për z. {...} është verifikuar kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”.

“Përvoja specifike”, nuk po e citoj. Duhet të paktën, në rastin konkret ka 8 vjet, duhet 1 vit sipas ligjit.

Për verifikimin e kandidatit në lidhje me pozicionin e këtij kriteri për lëvizjen paralele është mbajtur parasysh që ai ka kandiduar edhe nëpër pozicionet e lira në fushën

e së drejtës civile, çka do të thotë që duhet të ketë 1 vit përvojë profesionale si gjyqtar në këtë fushë të së drejtës.

Në përvojën profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati në fjalë, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016 dhe ka përvojë pune si në seksionin civil, ashtu edhe në atë penal. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 08.07.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016.

Me dekret të Presidentit të Republikës nr. 9326, datë 20.11.2015 emërohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjiqësor Tiranë.

Me vendim nr. {...}, datë 10.02.2017 të Këshillit të Lartë Drejtësisë caktohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjiqësor Pogradec.

Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Pogradec, datë 18.03.2022 ai ka qenë zgjidhur Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Pogradec.

Me vendim nr. 134, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, nga data 01.05.2023 transferohet në pozicionin e përhershëm si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, ku dhe aktualisht ushtron këtë funksion.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 8 vite. Në fakt është më shumë se 8 vite, është gati 9 vite. Por duke qenë se për disa muaj nuk plotësohet, llogaritet 8 vite, por që kuptohet e kalon kriterin.

Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, nga verifikimet rezulton se për kandidatin: “Nga verifikimi i regjistrimit të personelit për ish-Gjykatën e Rrethit Gjiqësor Pogradec rezulton se magjistrati {...}, në bazë të dekretit nr. {...}, datë 10.02.2017 ka filluar punë në datë 10.02.2017. Nuk ka nevojë t’i lexoj të gjitha sepse kemi një vendim me nr. 195, datë 09.04.2024 ku rezulton që

kandidati {...} ka plotësuar, pra Këshilli e ka kaluar një herë këtë procedurë formale dhe kështu që nuk është e nevojshme që në mënyrë të përsëritur unë të lexoj edhe një herë nga e para ato që kanë kaluar (kriteret).

Kështu që ju ftoj që të votoni kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës për lëvizjen në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Tabaku!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Nuk ka diskutime.

Kalojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 489, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

93

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shpërndarjen e disa pajisjeve të teknologjisë së informacionit, nëpër gjykatat”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shpërndarjen e disa pajisjeve të teknologjisë së informacionit, nëpër gjykatat”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me një pikë tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi shpërndarjen e disa pajisjeve të teknologjisë së informacionit, nëpër gjykatat” për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor pas miratimit të buxhetit të shtetit për vitin 2024, me vendimin nr.743, datë 29.12.2023 “Për detajimin e buxhetit vjetor në sistemin gjyqësor”, ka miratuar fonde në kodin e projektit “Blerje pajisje elektronike”

96

për sistemin gjyqësor në shumën 50,000 mijë lekë për vitin 2024, për nevojat e gjykatave të të tre niveleve.

Kjo procedurë tashmë është realizuar dhe pajisjet e IT-së janë bërë hyrje në magazinën e KLGJ-së.

Pas përfundimit të këtij procesi, Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për administrimin e pajisjeve dhe sistemeve të IT, në KLGJ dhe gjykatat e të gjitha niveleve, me memon datë 20.09.2024 ka kërkuar realizimin e procesit të shpërndarjes të pajisjeve IT. (bashkëlidhur memo datë 20.09.2024)

Po ashtu Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka kërkuar me emergjencë plotësimin e nevojës me 8 copë UPS, të cilat janë gjendje dhe në pronësi KLGJ-së, për të cilat vlerësojmë t'i transferohen kësaj gjykate.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare shqyrtimin dhe miratimin e relacionit dhe projektvendimit, mbi shpërndarjen (transferimin) e disa pajisjeve të IT nëpër gjykata sipas pasqyrave të mëposhtme.

Duke ju faleminderit për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Haxhiu!

Ka diskutime? Ka pyetje?

Nuk ka diskutime.

Nuk ka pyetje.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi shpërndarjen e disa pajisjeve të teknologjisë së informacionit, nëpër gjykata”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa aktiveve nëpër gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa aktiveve nëpër gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa aktiveve nëpër gjykata” për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Fjala për relatorin z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 269, datë 29.05.2024 “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa aktiveve nëpër gjykata” ka miratuar transferimin e aktiveve të gjykatave të cilat nuk ushtrojnë më aktivitetin e tyre pas implementimit të Hartës së Re Gjyqësore dhe u transferuan në ato gjykata të cilat

100

filluan veprimtarinë e tyre VKM nr.495, datë 21.07.2022. Krahas aktiveve të cilat u transferuan me vendimin e sipërcituar rezultuan në përfundim të këtij procesi edhe disa aktive të cilat nuk ishin përfshirë në listat e transferimit të miratuara me vendimin e kaluar të KLGJ.

Si rezultat i kësaj, struktura përgjegjëse (Drejtoria e Investimeve dhe Planifikimit Strategjik) për administrimin dhe menaxhimin e aktiveve në KLGJ, pasi administroi, vlerësoi dhe verifikoi edhe një herë të gjithë dokumentacionin e dërguar dhe procedurën e ndjekur nga gjykata, arriti në konkluzion se janë zbatuar të gjitha kërkesat për procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe Udhëzimin nr.30 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit dhe projektvendimit, mbi transferimit të aktiveve në gjykata, si më poshtë vijon:

Në Gjykatën Administrative të Apelit sipas pasqyrës nr. 1, 2 dhe 3 bashkëlidhur.

Në Gjykatën Kukës pasqyrat nr. 4 dhe nr. 5.

Në Gjykatën Durrës pasqyrat nr. 6, nr. 7, nr. 8.

Në Gjykatën Tiranë, 9, 10, 11.

Në Gjykatën Lezhë, 12.

Në Gjykatën Korçë, 13.

Në Gjykatën Gjirokastrë, 14, 15.

Në Gjykatën Shkodër sipas pasqyrës 16, 17.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë sipas pasqyrës nr. 18, 19, 20.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë sipas pasqyrës nr. 21 dhe 22 bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Faleminderit! Edhe një herë.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Haxhiu!

Ka diskutime? Ka pyetje?

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Unë kam vetëm një falënderim për këtë punë të jashtëzakonshme që është bërë në rishpërndarjen e transferimit të disa aktiveve nëpër gjykata. Ka bërë përshtypje mënyra skrupuloze e arshivimit, e identifikimit të të gjitha të mirave, mjeteve që kanë qenë në gjykatat të cilat nuk janë më pjesë, nuk ushtrojnë funksion dhe këto t'i çojmë në gjykatat ku kanë nevojë. Më pëlqen se është bërë aq e detajuar sa që janë përfshirë edhe prerëse lapsash, llastiqe për kapje dosjesh. Është skrupuloze.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime të tjera mbi përmbajtjen e projekt-aktit për mjetet e tjera të transferimit? Jo!

Atëherë, nëse s'ka diskutime, kalojmë në votim.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa aktiveve nëpër gjykata”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe disa gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe disa gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendi të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe disa gjykata” për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Relacion i cili është përditësuar. Për më tej fjalën relatorit z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit edhe një herë z. Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor gjatë këtij viti buxhetor janë depozituar kërkesa nga tetë gjykata të të gjitha niveleve të cilët kanë kërkuar miratimin për nxjerrjen nga

përdorimi të disa aktiveve, pjesë të inventarit të tyre deri më sot. Aktive të cilat janë propozuar për t'u miratuar për t'u nxjerrë nga përdorimi janë të karakterit elektronik, pajisje elektronike, pajisje zyre, pajisje sigurie, pajisje të tjera mjete motorike, të cilat krahas kërkesave të gjykatave kemi edhe një kërkesë për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve në KLGJ, se siç është e ditur kemi mbi katër vite që s'kemi nxjerrë jashtë përdorimit dhe kryesisht në KLGJ janë inventarë qarkullues ose siç i themi ne aktive qarkulluese (që është inventar i imët siç janë librat, lule, licenca softuerë të cilët kanë moshë deri 1-vjeçare, të cilat për një vit dalin jashtë përdorimit).

Gjykata që kanë paraqitur kërkesë për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve pajisje elektronike dhe pajisje zyre, etj., janë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Fier, Kukës, Tiranë, Vlorë, Durrës.

Kanë paraqitur kërkesë për nxjerrje nga përdorimi të mjeteve motorike Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Kukës, Shkodër, Vlorë. Në mënyrë analitike këto i paraqesim si më poshtë:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka propozuar sipas pasqyrës nr. 1 dhe nr. 2.

Gjykata Elbasan sipas pasqyrës nr. 3, nr. 4.

Gjykata Fier, sipas pasqyrës 5, 6, 7.

Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka paraqitur sipas pasqyrës nr. 8.

Këtu të nderuar anëtarë dua të ndaloj pak se tek pasqyra numër 8 kemi bërë një saktësim, pasi jua kishim dërguar materialet me e-mail. Kështu që pasqyra numër 8 është saktësuar për sa i përket Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila i ka sipas pasqyrës 9 dhe 10.

Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, sipas pasqyrës 11, 12.

Gjykata Durrës sipas pasqyrës 13, 14.

Gjithashtu Gjykata e Durrësit ka kërkuar edhe nxjerrje nga përdorimi të automjeteve sipas pasqyrës 15.

Gjykata Kukës, automjetet, sipas pasqyrës 16.

Gjykata Shkodër, automjetet sipas pasqyrës 17.

Gjykata Vlorë, automjetet sipas pasqyrës 18.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë sipas pasqyrës 19.

Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet Komisionit të vlerësimit të Aktiveve të KLGJ-së i ngritur me Urdhrin me nr. 40, datë 18.09.2024, ka paraqitur kërkesën për nxjerrje nga përdorimi të disa aktiveve kryesisht Inventar qarkullues/Inventar i imët si dhe Aktive afatgjata materiale/ Lule, Libra dhe Licenca (softuerë me afat 1-vjeçar) (sipas pasqyrës 20).

Struktura përgjegjëse në KLGJ (Drejtoria e Investimeve) për administrimin dhe menaxhimin e aktiveve, në përfundim të administrimit, vlerësimit dhe verifikimit të gjithë dokumentacionit të dërguar mbi procedurën e ndjekur nga gjykatat, konstatoi se, janë zbatuar të gjitha kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në lidhje me inventarizimin periodik, vlerësimin e aktiveve dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në sektorin publik.

Kështu, për sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr.30 “Për manaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, të Ministrisë së Financave, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit dhe projektvendimit për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve për të gjitha gjykatat sipër cituara si dhe disa aktiveve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe të evidentuara në mënyrë analitike sipas pasqyrave nga nr. 1 deri në pasqyrën nr.20, si më poshtë vijon.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Faleminderit edhe një herë!

Ilir Rusi: Ka diskutime?

Nuk ka diskutime.

Kalojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe disa gjykata”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 15 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurën e verifikimit të kancelarit në detyrë të papërfunduar nga relatorja, znj. Gentiana Muçaj”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

109

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.10.2024 (Pika 15)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

15. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurën e verifikimit të kancelarit në detyrë të papërfunduar nga relatorja, *znj. Gentiana Muçaj*”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Në vijim kemi një pikë tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurën e verifikimit të kancelarit në detyrë të papërfunduar nga relatorja, *znj. Gentiana Muçaj*” për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Ka diskutime?

Po, zoti Hado!

Ridvan Hado: Faleminderit!

Kjo pikë është përfshirë gabimisht në rendin e ditës, pasi rezulton që kjo çështje është në plenare.

Në këto kushte, duke qenë se kur u ripërcaktuan komisionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor u la që çështjet që janë në plenarë do të vazhdojnë me të njëjtin relator, nuk

110

ka vend për ndryshimin e relatorit. Kështu që propozoj ta heqim nga rendi i ditës.
Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Vazhdojmë me votimin e propozimit të z. Hado.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë kjo pikë u hoq nga shqyrtimi në këtë rend dite. Kështu që, do të vazhdojë raporti i relatores me kancelarin përkatës në lidhje me shqyrtimin e akteve dhe vlerësimin e tyre.

* * *

(Pika 15 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.10.2024)

Pika 16 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça):

16.1 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”;

16.2 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:54 dhe mbaroi në orën 16:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

112

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.10.2024 (Pika 16)***

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë.

3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala (në sallë deri në pikën 5) dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

16. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça):

16.1 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”;

16.2 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Ilir Rusi: Në vijim, edhe për shkak të njoftimit të bërë nga ana e administratës, kanë ardhur pëlqimet nga magjistratët znj. {...} dhe z. {...} në lidhje me transferimin e tyre dhe kemi të bëjmë me një pikë përkatëse që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës” dhe “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të

gjqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Neve e kaluam pak më përpara në shqyrtim çështjen e hapjes së procedurës së transferimit të përkohshëm në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm Tiranë dhe Durrës. Vendosëm që të kërkojmë mendim kandidatëve pavarësisht se kishin pëlqim paraprak për shkak të kërkesave të tyre.

Në relacionin përkatës ju kemi bërë me dije edhe situatën e gjykatave përkatëse ku ato aktualisht janë të transferuar (Tirana dhe Durrësi) dhe po ashtu edhe qëndrimet e gjykatave nga vijnë. Gjykata e Gjirokastrës ka dhënë pëlqimin duke dhënë opinionin që nuk cenohet funksionaliteti i gjykatës dhe në analizë të statistikave të tyre japin miratimin që periudha e transferimit të jetë për një vit- zonja {...}, drejtuesi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë; dhe zoti {...} po ashtu jep pëlqimin për një periudhë transferimit prej një viti – është drejtues i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Na kanë ardhur me e-mail edhe pëlqimet që kërkuam nga z. {...} dhe znj. {...}, kështu që, meqenëse problematika është e qartë, detajet janë të sqaruara në relacion, propozoj që të kalojmë në votimin e dy projektvendimeve për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe të z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime. Atëherë, fillimisht fillojmë me votimin e projektvendimit që ka të bëjë “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me projektvendimin “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord/Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Në vijim kemi të bëjmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që për shkak të karakterit të saj ajo shqyrtohet me dyer të mbyllura.

Kështu që në raport me pjesëmarrjen e anëtarëve në këtë pikë, do vijojmë mbledhjen pa komunikim me të tretët dhe me dyer të mbyllura.

* * *

(Pika 16 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor